

Republika e Maqedonisë së Veriut
Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional

Plani strategjik i
Agjencisë për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional
periudha 2024 – 2028

“Për ditë më të sigurta pensionale”

Përmbajtja

- Përmbajtja... 2
- Shkurtesat... 4
- Parathënie e Kryetarit të Këshillit të Ekspertëve... 5
- Hyrje... 6
- Misioni... 7
- Vizioni... 7
- Vlerat... 7
- Sistemi pensional në Maqedoninë e Veriut... 8
- Agjencia për Mbikëqyrjen e Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (MAPAS)... 10
- Pjesëmarrësit kryesorë... 14
- Qëllimi strategjik 1:... 15
- Qëllimi 1.1... 16
- Qëllimi 1.2... 18
- Qëllimi 1.3... 19
- Qëllimi 1.4... 21
- Qëllimi strategjik 2:... 22
- Qëllimi 2.1... 23
- Qëllimi 2.2... 25
- Qëllimi 2.3... 27
- Qëllimi 2.4... 30
- Qëllimi 2.5... 31
- Qëllimi 2.6... 32
- Qëllimi 2.7... 33
- Qëllimi strategjik 3:... 35
- Qëllimi 3.1... 36
- Qëllimi 3.2... 36
- Qëllimi 3.3... 39
- Qëllimi 3.4... 41
- Qëllimi 3.5... 43

Shtojca 1 - Korniza e mjeteve financiare për realizimin e planit strategjik për periudhën 2024-2028 Error! Bookmark not defined.

Shtojca 2 - Plani i veprimit për vitin 2024, masat e suksesit dhe aktivitetet, evaluimi i planit me rezultatet e arritura (viti bazë 2023)... Error! Bookmark not defined.

- Qëllimi strategjik 1 Qëllimi 1.1... Error! Bookmark not defined.
- Qëllimi strategjik 1 Qëllimi 1.2... Error! Bookmark not defined.
- Qëllimi strategjik 1 Qëllimi 1.3... Error! Bookmark not defined.
- Qëllimi strategjik 1 Qëllimi 1.4... Error! Bookmark not defined.
- Qëllimi strategjik 2 Qëllimi 2.1... Error! Bookmark not defined.
- Qëllimi strategjik 2 - Qëllimi 2.2... Error! Bookmark not defined.
- Qëllimi strategjik 2 - Qëllimi 2.3... Error! Bookmark not defined.
- Qëllimi strategjik 2 - Qëllimi 2.4... Error! Bookmark not defined.

- Qëllimi strategjik 2 - Qëllimi 2.5... Error! Bookmark not defined.
- Qëllimi strategjik 2 Qëllimi 2.6... Error! Bookmark not defined.
- Qëllimi strategjik 2 - Qëllimi 2.7... Error! Bookmark not defined.
- Qëllimi strategjik 3 Qëllimi 3.1... Error! Bookmark not defined.
- Qëllimi strategjik 3 Qëllimi 3.2... Error! Bookmark not defined.
- Qëllimi strategjik 3 - Qëllimi 3.3... Error! Bookmark not defined.
- Qëllimi strategjik 3 Qëllimi 3.4... Error! Bookmark not defined.
- Qëllimi strategjik 3 - Qëllimi 3.5... Error! Bookmark not defined.

Shkurtesat

ASO - Agjencia për Mbikëqyrjen e Sigurimeve

PBB – Produkti i brendshëm bruto

Shtylla e dytë - sigurimi pensional i detyrueshëm me financim kapital

DPF - fondet pensionale vullnetare

EU - Unioni Evropian

ZPF - fondet pensionale të detyrueshme

IOPS Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve Pensionalë (International Organisation of Pension Supervisors)

KHV - Komisioni për letrat me vlerë

MAPAS - Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional

MMF - Fondi Monetar Ndërkombëtar

MTSP - Ministria e Punës dhe Politikës Sociale

MF - Ministria e Financave

NBRSM - Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

OECD - Organizata për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim (Organisation for Economic Co-operation and Development)

OECD - INFE - Organizata për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim Rrjeti ndërkombëtar për edukim financiar

Shtylla e parë - sigurimi i detyrueshëm pensional dhe invalidor në bazë të solidaritetit gjeneracional; SB - Banka Botërore

Shtylla e tretë - sigurimi pensional vullnetar me financim kapital

UJP - Drejtoria e të hyrave publike

Fondi i PIOSM - Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë së Veriut; FSAP - Programi për vlerësimin e sektorit financiar (Financial Sector Assessment Program)

Parathënie e kryetarit të Këshillit të Ekspertëve

Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional MAPAS është institucion rregullator dhe mbikëqyrës i cili në vazhdimësi kujdeset për interesat e anëtarëve dhe të anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale dhe nxit zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital. Parakushti kryesor për punë të suksesshme është identifikimi i gjendjeve të synuara dhe për këtë arsye MAPAS zbaton planifikimin strategjik si pjesë e menaxhimit bashkëkohor dhe si mjet për përshtatje të shpejtë dhe efikase ndaj kushteve të ndryshueshme të veprimit.

Përmes analizës së gjendjes ekzistuese në të cilën punojmë dhe veprojmë dhe evaluimit të arritjeve të deritanishme, konfirmuam misionin tonë, vizionin dhe vlerat. Identifikuam qëllimet tona kryesore dhe projektuam gjendjen e dëshiruar të ardhshme në afat të mesëm, në përputhje me kapacitetet dhe resurset tona, përmes aktiviteteve të definuara. Në një kornizë kohore të përcaktuar i definuam edhe masat të cilat do të na jenë tregues i qartë për suksesin e aktiviteteve. Gjendja e ardhshme e projektuar drejt së cilës synojmë do të jetë lëvizësi ynë kryesor drejt realizimit të qëllimeve.

MAPAS beson dhe pret që, duke zbatuar aktivitetet e veta të përditshme, do të realizojë Planin Strategjik për periudhën 2024-2028. Realizimi i Planit Strategjik për periudhën 2024-2028 do të ketë ndikim të madh në forcimin e komponentës së financimit kapital nga sistemi pensional në vendin tonë, përmes forcimit të menaxhimit me rreziqe dhe kontributit drejt zhvillimit të një sistemi pensional të sigurt dhe transparent i cili ka mbështetjen e anëtarësisë dhe publikut, si dhe përmes përmirësimit të kapacitetit të MAPAS në drejtim të forcimit të rolit të tij mbikëqyrës dhe rregullator në sistemin pensional.

Anëtarët e Këshillit të ekspertëve dhe të gjithë të punësuarit në MAPAS, mbështesin zbatimin e planit strategjik dhe në mënyrë të vazhdueshme ndjekin progresin e arritur në lidhje me qëllimet e vendosura në drejtim të realizimit të misionit të vet për shkak të ditëve pensionale më të sigurta të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kryetar i Këshillit të ekspertëve,

Maksud Ali

Hyrje

Plani strategjik i MAPAS përcaktohet në bazë të misionit, vizionit dhe vlerave të MAPAS, duke marrë parasysh gjendjen ekzistuese në të cilën vepron MAPAS, mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm dhe sfidat kryesore. Plani strategjik përmban tri qëllime strategjike dhe gjashtëmbëdhjetë qëllime në drejtim të realizimit të qëllimeve kryesore për periudhën e ardhshme pesëvjeçare.

Plani strategjik evaluohet çdo vit dhe rishikohet një herë në tre vjet ose më shpesh nëse përcaktohet një nevojë e tillë gjatë evaluimit. Evaluimi bëhet në bazë të masave/treguesve të definuar që vlerësohen në afatshkurtër (një vit) dhe afatmesëm (pesë vite). Plani strategjik paraqet bazë për planifikimin vjetor të aktiviteteve të MAPAS.

Në shtojcë të Planit Strategjik për periudhën 2024-2028 janë:

1. Korniza e mjeteve financiare për realizimin e planit strategjik për periudhën 2024-2028
2. Plani i aksionit për vitin 2024, masat për sukses dhe aktivitetet, evaluimi i planit me rezultate të arritura (viti bazë 2023)

Misioni

MAPAS të mbrojtë interesat e anëtarëve dhe të anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale dhe të nxitë zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital për shkak të ditëve pensionale më të sigurta.

Vizioni

MAPAS të njihet si institucion i pavarur, profesional dhe transparent i cili mbron dhe avancon sigurimin pensional me financim kapital.

Vlerat

Profesionalizëm - aplikimi i standardeve që priten nga një institucion profesional, të vërejtura në besueshmëri, diskretesion, paanshmëri dhe raport të ndershëm në të gjitha sferat nga veprimi i vetë

- Përgjegjësi - marrja e përgjegjësisë për aksionet e veta dhe për rezultatet të cilat rrjedhin prej tyre
- Punë ekipore - punë e përbashkët për realizimin e qëllimeve dhe ndarjen e ideve dhe përvojave
- Integritet - sigurimi i konsistencës, saktësisë dhe ndershmërisë gjatë realizimit të qëllimeve
- Transparencë - sigurimi i informimit në kohë dhe të qartë të publikut për aktivitetet e MAPAS
- Përkushtim - realizim me përkushtim i misionit dhe vizionit të MAPAS.

Sistemi pensional në Maqedoninë e Veriut

Sistemi pensional maqedonas është pjesë e sigurimit social të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ai ka strukturë të një sistemi me tre shtylla me mënyrë të kombinuar të financimit të pensioneve të ardhshme dhe diversifikim të rreziqeve demografike dhe ekonomike, me qëllim sigurimin e pensionit të sigurt për gjeneratat e tanishme dhe të ardhshme të pensionistëve dhe stabilitet financiar afatgjatë të sistemit. Kjo strukturë është rezultat i reformës rrënjësore të sigurimit pensional dhe invalidor, e cila u përgatit për shumë vite, ndërsa korniza e saj ligjore u vendos në vitin 2000.

Tri shtyllat e sistemit pensional maqedonas janë:

- Shtylla e parë – sigurimi në bazë të solidaritetit gjeneracional
- Shtylla e dytë – sigurimi pensional i detyrueshëm me financim kapital
- Shtylla e tretë – sigurimi pensional vullnetar me financim kapital

Shtylla e parë financohet në bazë rrjedhëse (PAYG), që do të thotë se me kontributet nga të siguruarit ekzistues paguhen pensionet e pensionistëve aktualë. Kjo shtyllë funksionon në parimin e të ashtuquajturave pensione të definuara, përkatësisht përmes saj sigurohen pensione sipas formulës së përcaktuar paraprakisht për llogaritjen e pensionit. Nga shtylla e parë paguhet një pjesë e pensionit të pleqërisë, pensioni invalidor, pensioni familjar, si dhe shuma më e ulët e pensionit.

Shtylla e dytë dhe e tretë janë sigurim pensional me financim kapital në të cilin bëhet kapitalizimi i kontributeve të paguara në emër dhe për llogari të anëtarit. Këto dy shtylla funksionojnë në parimin e të ashtuquajturave kontribute të definuara, përkatësisht te to paraprakisht është përcaktuar niveli i kontributit që paguhet, ndërsa pensioni përcaktohet më pas varësisht nga shuma e akumuluar. Nga shtylla e dytë paguhet një pjesë e pensionit të pleqërisë. Nga shtylla e tretë sigurohet mbrojtja nga pleqëria, invaliditeti dhe vdekja.

Sigurimi pensional me financim kapital ndryshon rrënjësisht nga sigurimi pensional me financim rrjedhës edhe në pikëpamje të trajtimit dhe evidencës së kontributeve të paguara dhe në pikëpamje të përcaktimit dhe pagesës së pensionit. Në këtë sigurim çdo anëtar ka llogari individuale në të cilën evidentohen mjetet e tij dhe sigurohet lidhje e ngushtë dhe varësi midis vëllimit të kontributeve të paguara dhe pensioneve të ardhshme që do të realizojë çdo person. Kjo mënyrë e sigurimit është e bazuar mbi parimin e akumulimit të mjeteve nga kontributet në llogari individuale, të cilat më tej investohen dhe kthimi i realizuar nga investimet, i zbritur për shpenzimet e punës së sistemit, në plotësi u shtohet mjeteve të akumuluar në llogaritë individuale. Pensioni i ardhshëm varet nga mjetet e akumuluar në llogarinë individuale dhe nga kohëzgjatja e pritshme e jetës gjatë pensionimit, përkatësisht periudha e pritshme e shfrytëzimit të pensionit.

Institucionet që marrin pjesë në sistemin pensional janë:

- **Ministria e Punës dhe Politikës Sociale** – kompetente për krijimin dhe udhëheqjen e politikës së sigurimit pensional dhe invalidor dhe kryerjen e mbikëqyrjes në zbatimin e ligjshmërisë së atij sigurimi.
- **Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional** – institucion rregullator dhe mbikëqyrës, i cili mbron interesat e anëtarëve dhe të anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale, forcon vetëdijen e publikut për karakteristikat e këtij lloji të sigurimit dhe nxit zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital. •
- **Shoqëria pensionale** – shoqëri aksionare, veprimtaria e vetme e së cilës është menaxhimi me mjetet e fondeve pensionale. Sistemi pensional në Maqedoninë e Veriut ka mundësinë për themelimin e tre llojeve të shoqërive:
 - Shoqëri për menaxhimin me fondet pensionale të detyrueshme
 - Shoqëri për menaxhimin me fondet pensionale vullnetare
 - Shoqëri për menaxhimin me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ekzistojnë tri shoqëri pensionale të cilat menaxhojnë me nga një fond pensional të detyrueshëm dhe me nga një fond pensional vullnetar dhe një shoqëri pensionale e cila menaxhon vetëm me fond pensional vullnetar. Njëra nga shoqëritë pensionale ka kombinim të aksionarëve vendorë (49% pjesëmarrje) dhe të huaj (51% pjesëmarrje), dy shoqëri pensionale kanë aksionar të vetëm të huaj (100% pjesëmarrje) dhe një shoqëri pensionale ka aksionar të vetëm vendor (100% pjesëmarrje).

- Ruajtësi i pronës së fondit pensional – bankë e cila në mënyrë të sigurt i ruan mjetet e fondit pensional në llogari të veçantë, ndaras nga mjetet e shoqërisë pensionale. Funkcioni i ruajtësit të pronës, edhe për fondet pensionale të detyrueshme edhe për ato vullnetare është kompetencë e bankave afariste të cilat kanë lidhur kontrata me shoqëritë pensionale për ruajtjen e mjeteve të fondeve pensionale.
- Drejtoria e të Hyrave Publike – kryen arkëtim të centralizuar të kontributeve dhe deri te Fondi i PIOSM dorëzon kontributet e tërësishme për sigurim pensional dhe invalidor.
- Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë së Veriut – kryen shpërndarjen e kontributeve për sigurim pensional midis shtyllës së parë dhe të dytë dhe kryen transferimin e kontributeve dhe të dhënave përkatëse për anëtarët në fondet pensionale të detyrueshme të zgjedhura.

Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional (MAPAS)

MAPAS është themeluar në korrik të vitit 2002 si trup mbikëqyrës dhe rregullator i sigurimit pensional me financim kapital. MAPAS kryen mbikëqyrje të punës së shoqërive pensionale, fondeve pensionale dhe ruajtësve të pronës dhe sjell akte nënligjore dhe akte të tjera, me çka kontribuon për zbatimin e plotë të ligjeve që rregullojnë sigurimin pensional me financim kapital.

Qëllimi themelor i MAPAS është të mbrojë interesat e anëtarëve dhe të anëtarëve të pensionuar dhe të nxitë zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital në Republikën e Maqedonisë.

MAPAS është përgjegjëse për lëshimin, tërheqjen dhe shfuqizimin e lejeve për themelimin e shoqërive pensionale dhe të aprovimeve për menaxhim me fondet pensionale; kryen mbikëqyrje të punës së shoqërive pensionale, fondeve pensionale, si dhe të ruajtësve të pronës dhe të menaxherëve të huaj të mjeteve. MAPAS bashkëpunon me MPPS, MF, BPRMV, KHV, ASO dhe me institucione të tjera me qëllim që suksesshëm ta rregullojë dhe mbikëqyrë sigurimin pensional me financim kapital në Maqedoninë e Veriut. Përveç raportit vjetor për punën e saj, MAPAS përgatit dhe publikon raport vjetor për gjendjet në sigurimin pensional me financim kapital si një nga mënyrat për sigurimin e transparencës së sistemit.


Për momentin, MAPAS i kryen funksionet e veta me gjithsej 28 të punësuar. Me MAPAS-in udhëheq dhe menaxhon Këshilli i ekspertëve i përbërë prej pesë anëtarëve (tre ekspertë të angazhuar profesionalisht dhe dy anëtarë të jashtëm), nga të cilët njëri është kryetar. Struktura organizative e MAPAS është e përbërë nga sektorë, degë, departamente dhe revizioni i brendshëm.

- **Dega për marrëdhënie me publikun dhe standardizim (DMPS):** Dega kujdeset për: proceset e nevojshme për organizimin e sistemit për menaxhim me cilësinë të jenë të vendosura, të zbatuara dhe të mirëmbajtura, vendosjen e sistemit për mbrojtjen e të dhënave personale në MAPAS, procedurën për sigurimin e qasjes së lirë në informatat me karakter publik, vendosjen e mënyrës dhe procedurës për informimin e publikut, përgatitjen e njoftimeve për mediat, organizimin e konferencave për shtyp, planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve që të mbahet paraqitja e favorshme për MAPAS-in në publik. Gjithashtu, Dega është përgjegjëse për organizimin dhe planifikimin e punëve dhe detyrave të kryetarit të Këshillit të ekspertëve, anëtarëve të angazhuar profesionalisht si dhe të anëtarëve të jashtëm. Për momentin, në këtë degë punojnë një udhëheqës dege, një udhëheqës departamenti dhe një bashkëpunëtor i ri. •
- **Dega për informatikë (DI):** Dega për informatikë në MAPAS kujdeset për mirëmbajtjen rrjedhëse të zgjidhjeve ekzistuese softuerike lidhur me shtyllën e dytë dhe të tretë nga sistemi pensional si dhe për zhvillimin e zgjidhjeve të reja softuerike në bashkëpunim me kompani të jashtme softuerike, për konsistencën e të dhënave në bazat e të dhënave, për rrjedhën e përcjelljes së të dhënave midis MAPAS-it dhe subjekteve me të cilët bashkëpunon. Dega për informatikë kujdeset edhe për mirëmbajtjen e serverëve si dhe për pajisjet e tjera harduerike me të cilat disponon MAPAS. Për momentin në këtë degë punojnë një udhëheqës dege dhe një udhëheqës departamenti.

- **Spektori për kontroll financiar (SKF):** Ky sektor kryen kontroll financiar të fondeve pensionale dhe ruajtësve të pronës nga aspekti i kontrollit të procesit të transferimit të kontributeve nga momenti i dorëzimit të të dhënave nga Fondi i PIOSM deri në momentin e pagesës së tyre në fondet pensionale, kontrollin e investimit dhe vlerësimin e mjeteve të fondeve pensionale, si dhe kontrollin e procesit të pagesës së pensioneve dhe kompensimeve pensionale nga fondet pensionale. Për momentin, në Sektorin për kontroll financiar punojnë dy udhëheqës departamentesh, një këshilltar, një bashkëpunëtor i lartë, një referent i pavarur dhe një referent i ri.
- **Spektori për kontroll institucional (SKI):** Ky sektor kryen kontroll të punës administrative, organizative dhe financiare të shoqërive pensionale. Udhëheq Regjistrin e anëtarëve dhe vepron sipas lëndëve që rrjedhin nga anëtarësimi në fondet pensionale, përkatësisht kryen kontroll të procedurës së anëtarësimit, kalimit dhe realizimit të të drejtave të anëtarëve. Për momentin, në Sektorin për kontroll institucional punojnë një udhëheqës sektori, një udhëheqës departamenti, një këshilltar, një bashkëpunëtor i ri dhe një referent i lartë.
- **Spektori për punë juridike (SPJ):** Në kuadër të kompetencave në këtë sektor përgatiten akte dhe dokumente juridike të përgjithshme dhe konkrete lidhur me punën e MAPAS-it, zbatohen procedurat për lëshimin e lejeve dhe aprovimeve për themelimin e shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale, jepen aprovime për ndryshimet në shoqëritë pensionale dhe kryhen punë nga burimet njerëzore. Për momentin, në këtë sektor punojnë një udhëheqës sektori, dy udhëheqës departamentesh dhe një këshilltar. • •
- **Spektori për hulumtim dhe bashkëpunim ndër-institucional (SHBN):** Ky sektor kryen ndjekjen dhe analizën e sistemit pensional dhe hulumtime makroekonomike, duke përfshirë përgatitjen e raporteve statistikore dhe të raportit për gjendjet e sigurimit pensional me financim kapital, përgatitjen dhe përditësimin e programit për provimin për agjentë, propozimin e metodës për llogaritjen e kthimit dhe ponderit dhe llogaritjen e tyre, propozimin e metodologjisë për llogaritjen e pensioneve dhe analiza të tjera të alternativave të reja për zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital. Gjithashtu ky sektor është përgjegjës edhe për mirëmbajtjen e bashkëpunimit me institucionet me të cilat MAPAS ka nënshkruar memorandume për bashkëpunim. Për momentin, në këtë sektor punojnë një udhëheqës sektori dhe një udhëheqës departamenti.
- **Spektori për punë administrativo-financiare (SPAF):** Ky sektor është përgjegjës për punët administrative dhe financiare të cilat janë të domosdoshme për punën e papenguar të MAPAS-it, të cilat përfshijnë përgatitjen dhe ekzekutimin e planit financiar të MAPAS-it, raportet për punën financiare, kontabilitetin, zbatimin e procedurave për ndarjen e kontratave për furnizime publike, punën arkivore dhe punë të tjera administrative. Për momentin, në këtë sektor punojnë një udhëheqës sektori, dy udhëheqës departamentesh, një referent i lartë dhe një referent i ri.
- **Revizioni i brendshëm (RB):** Detyrat bazë të revizionit të brendshëm janë vlerësimi i faktorëve të rëndësishëm të rrezikut dhe dhënia e këshillave Këshillit të ekspertëve të MAPAS-it për zvogëlimin e faktorëve të rrezikut; përcaktimi dhe vlerësimi i ekonomikitetit, efikasitetit dhe efektivitetit në punën e sistemeve për menaxhim financiar dhe kontroll dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e punës, në bazë të analizave; verifikimi i saktësisë dhe kompletësisë së evidencës kontabël dhe raporteve

financiare; përcaktimi dhe vlerësimi i harmonizimit të punës me ligjet, aktet nënligjore dhe ato interne dhe ndjekja e zbatimit të masave të ndërmarra nga anëtarët e Këshillit të ekspertëve të MAPAS-it në bazë të raportit të revizionit. Për momentin, në revizionin e brendshëm punon një revizor i brendshëm.

Skema organizative e MAPAS



Pjesëmarrësit kryesorë

Klientë:
Anëtarë të fondeve pensionale,
Shoqëri pensionale
Ruajtës të pronës së fondeve pensionale
Klientë të ardhshëm
Qytetarë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
Pjesëmarrës të brendshëm:
Të punësuar në MAPAS
Këshilli i ekspertëve të MAPAS.
Pjesëmarrës të jashtëm
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
Ministria e Financave
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut
Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
Bursa e Maqedonisë
Komisioni për Letra me Vlerë
Agjencia për Mbikëqyrjen e Sigurimeve
Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë së Veriut
Furnizues
Konsulentë
Bashkëpunëtorë ndërkombëtarë:
Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve Pensionalë IOPS
Delegacioni i BE-së
Banka Botërore
Mbikëqyrës pensionalë nga vende të tjera
Pjesëmarrës të tjerë:
Mediat
Odat ekonomike dhe sindikatat.

Qëllimi strategjik 1:

Sigurimi i menaxhimit me rreziqet që u kërcënohen mjeteve dhe pensioneve dhe kompensimeve pensionale të anëtarëve të fondeve pensionale, si dhe autoritetit të sistemit, dhe zvogëlimi i të njëjtave në nivelin më të ulët të mundshëm.

Kursimi pensional është investim afatgjatë me të cilin duhet të menaxhohet, duke mbajtur ekuilibër midis rrezikut dhe kthimit i cili është optimizuar gjatë ciklit jetësor të anëtarëve. Sistemi ekzistues u imponon stimuj të fortë shoqërive pensionale për arritjen e minimizimit afatshkurtër të volatilitetit që mund të arrihet vetëm nëse rriten rreziqet e tjera, siç janë për shembull mospërputhja e afateve (duration mismatch) dhe inflacioni, shikuar në afat më të gjatë, e me këtë kufizohen edhe mundësitë për realizimin e kthimeve më të larta (kthimet që mund të vendosen si qëllim ose të realizohen). MAPAS do të vazhdojë të punojë në drejtim të zvogëlimit të këtij lloji të stimujve, me atë që do të mundësojë të zhvillohet qasje strategjike më intensive ndaj investimit me çka, si qëllim, do të vendosen kthimet afatgjata dhe menaxhimi me rreziqet përkatëse. Njëkohësisht, MAPAS do të angazhohet për transparencë më të madhe në raport me transformimin e kësaj strategjie në procedura konkrete, si dhe për avancimin e procesit të menaxhimit me rreziqet. Kompensimet që arkëtohen nga ana e shoqërive pensionale ndikojnë dukshëm dhe mund ta zvogëlojnë vlerën e pensioneve dhe kompensimeve pensionale të ardhshme sepse arkëtohen gjatë moshës së punës të anëtarëve, prandaj është e rëndësishme së veçantë që MAPAS edhe më tutje të vazhdojë me aplikimin e qasjes së suksesshme për zvogëlimin gradual të kufirit të sipërm të kompensimeve për shkak të zvogëlimit të ndikimit të tyre.

Qëllimi 1.1 Krijimi i kushteve për arritjen e normave maksimale të kthimit në afat të gjatë me rrezik minimal, përmes promovimit të proceseve me cilësi të lartë për menaxhimin e portofolave investues

Në fillimet e sistemit, derisa shoqëritë pensionale zhvillojnë kapacitetet dhe ekspertizën, ishte e kuptueshme që minimizimi i volatilitetit investues do të ishte një shtytës i rëndësishëm i sjelljes investuese. Në atë periudhë kthimet reale ishin mjaft të ulëta dhe të planifikuara në afat të shkurtër. MAPAS pret që shoqëritë pensionale të arrijnë pjekuri në funksionin investues, duke punuar aktivisht në arritjen e kthimeve të dëshiruara më të larta nga investimet në afat të gjatë dhe, në përputhje me parimin e maturisë (prudencës), të mbajnë ekuilibër midis rrezikut dhe kthimit. Kjo do të thotë që anëtarët e bordeve drejtuese të shoqërive pensionale duhet ta bindin MAPAS-in se:

- Vendimet që kanë të bëjnë me portofolin e fondit pensional bazohen në analiza dhe këshilla me cilësi të lartë dhe të përshtatshme;
- Qëllimi i fondeve pensionale është fitimi sa më i lartë i mundshëm në afat të gjatë, ndërsa realizueshmëria e tij të bazohet në analiza paraprake;
- Në strategjinë e investimit përshkruhen veprimet që do të ndërmerren në afat të gjatë, me qëllim realizimin e fitimit më të lartë vetëm në dobi të anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondit pensional dhe përmes diversifikimit dhe analizës financiare të minimizohet rreziku nga humbjet, të cilat kanë ndodhur për shkak të mospagesës nga emetuesi ose pala tjetër kontraktuese, të cilat rrjedhin nga ndikimi i tregjeve financiare vendore dhe të huaja dhe të cilat janë pasojë e shitjes së mjeteve të fondit pensional për shkak të sigurimit të likuiditetit të fondit pensional;
- Në bazë të strategjisë së investimit të paktën një herë në vit për secilin fond pensional përgatitet dokument për mënyrën e zbatimit të strategjisë së investimit për 12 muajt e ardhshëm, i cili përmban qëllime të sakta dhe devijime të lejuara për investim sipas klasave të mjeteve, kufizime të brendshme, volatilitet relativ sipas klasave të mjeteve dhe ekspozim ndaj rreziqeve;
- Të gjitha aktivitetet investuese janë në përputhje me dokumentacionin e investimit dhe çdo mospërputhje me dokumentacionin e investimit shpejt eliminohet;
- Personat e autorizuar për menaxhimin e rreziqeve vazhdimisht i ndjekin rreziqet dhe raportojnë për rreziqet që i kanosen portofolit dhe ndërmarrin masa përkatëse për minimizimin e tyre;
- Anëtarët e Bordit Drejtues rregullisht i ndjekin rezultatet e investimit në bazë të analizave të detajuara të përgatitura nga sektorët.

Në atë drejtim, funksioni i MAPAS do të jetë vazhdimisht të punojë me shoqëritë pensionale me qëllim që të sigurohet se ato zbatojnë politikë të përshtatshme dhe veprojnë në mënyrë të drejtë sipas saj dhe njëkohësisht të zvogëlojë përpjekjen e tyre për planifikim në afat më të shkurtër.

MAPAS do t'i analizojë informacionet që rrjedhin nga raportet për portofoliet e fondeve pensionale dhe në terren do t'i kontrollojë proceset dhe politikat, në drejtim të konfirmimit se përparimi është i kënaqshëm dhe se shoqëritë pensionale punojnë në përputhje me përvojat më të mira në sferën e investimit dhe se veprimet e tyre nuk devijojnë nga planet e tyre investuese. Për të forcuar praktikën e mirë në atë fushë, MAPAS do të kërkojë sigurim nga shoqëritë pensionale se ndërmarrin veprime për zhvillimin e analizave të tyre, strategjive dhe menaxhimit të rreziqeve dhe konfirmim për zbatimin e tyre. Njëkohësisht, MAPAS do t'u ndihmojë shoqërive pensionale që të fitojnë kuptim për përvojat më të mira gjatë zbatimit të detyrimeve në atë fushë. Kjo do të mund të realizohej përmes seminareve, udhëzimeve dhe sigurisht përmes rregulloreve. Gjithashtu, MAPAS do të angazhohet përmes krijimit të një kornize të favorshme juridike dhe politikave, si dhe përmes vendosjes së një kornize institucionale, në mënyrë të strukturuar dhe strategjike të nxisë shoqëritë pensionale që të integrojnë aspektet ekonomike, sociale dhe ekologjike në punën e tyre.

MAPAS pret që shoqëritë pensionale vetë ta njohin nevojën për zhvillimin e proceseve afariste që rrjedhin nga veprimtaria, e veçanërisht në drejtim të vendosjes së multifondeve, e cila në vetvete kërkon sofistikim më të madh. Sigurisht, MAPAS do të propozojë ndryshime në rregullativë në drejtim të krijimit të një baze ligjore dhe nënligjore për funksionimin e multifondeve.

Investimi i mjeteve dhe marrja e vendimeve investuese duhet të jenë në përputhje me parimin e prurës, me planet vjetore investuese dhe me menaxhimin e rreziqeve.

Kjo është gjithashtu pjesë përbërëse e Qëllimit 1.4. që ka të bëjë me përmirësimin dhe avancimin e supervizionit përmes vlerësimit të rreziqeve në sistem.

Qëllimi 1.2

Promovimi i qeverisjes korporative me cilësi të lartë dhe menaxhimit të rreziqeve në shoqëritë pensionale për të siguruar minimizimin e rreziqeve

Rreziqet në shoqëritë pensionale do të zvogëlohen ose do të mbahen në nivel të ulët nëse ekzistojnë kontrolle që zbatohen në mënyrë të duhur dhe nëse shoqëritë kanë vendosur politika të përshtatshme për përmbushjen efektive të detyrimeve ndaj anëtarëve të fondeve pensionale. Kjo do të arrihet veçanërisht nëse shoqëritë pensionale kanë metoda të suksesshme për menaxhimin e rreziqeve. Një pjesë e detyrimit fiduciar të bordeve drejtuese të shoqërive pensionale është që ato të sigurojnë se të gjitha kontrollet e nevojshme janë vendosur dhe se vendimet merren në mënyrë objektive, në bazë të provave të mjaftueshme dhe kuptimit të rrezikut, duke përjashtuar mundësinë që të shfaqet konflikt interesi.

MAPAS do ta përforcojë atë mesazh duke ua përcaktuar qartë shoqërive pensionale detyrimet dhe duke kontrolluar zbatimin e tyre. Prioriteti për përmirësimin e qeverisjes korporative të shoqëritë pensionale është që ato të jenë në gjendje të tregojnë se janë plotësisht të harmonizuara me kontrollin e brendshëm dhe rregulloret dhe se e zhvillojnë funksionin e menaxhimit të rreziqeve. Pikërisht për këtë arsye, MAPAS nga shoqëritë pensionale do të kërkojë të dorëzojnë konfirmim vjetor se kanë vendosur procedura të përshtatshme për qeverisje korporative. Më pas, MAPAS do ta kontrollojë respektimin dhe përputhshmërinë e tyre me qëllim që të sigurohet se shoqëritë pensionale nuk e kanë informuar MAPAS gabimisht.

Pasi të sigurohet se sistemi i menaxhimit në shoqëri është i përshtatshëm, atëherë MAPAS do të mund të jetë më efikase në punën e saj, sepse një pjesë e përgjegjësive për proceset kryesore të kontrollit do të mund t'ua kalojë shoqërive. Kjo do të mund të ndodhë vetëm atëherë kur MAPAS do të ketë besim të mjaftueshëm në menaxhimin e shoqërive pensionale, gjë që, në fakt, paraqet edhe një arsye shtesë që MAPAS t'i përforcojë mesazhet ndaj shoqërive në atë drejtim.

Sigurimi i standardeve të larta në qeverisjen korporative dhe menaxhimin e rreziqeve nënkupton që MAPAS t'u tregojë qartë shoqërive pensionale se çfarë, në fakt, pritet prej tyre dhe të marrë pajtimin e tyre lidhur me këtë. Kjo mund të bëhet përmes Kodit të qeverisjes korporative, i cili paraqet një pikë të mirë fillestare. Më pas, MAPAS do ta kontrollojë implementimin dhe do t'u propozojë shoqërive pensionale eliminimin e parregullsisve, dhe e gjithë kjo do të mbështetet me mundësinë për ndërmarrjen e masave të një niveli më të lartë nëse shoqëritë nuk përputhen me kërkesat e MAPAS.

Qëllimi 1.3

Punë për uljen e vazhdueshme të ndikimit që kanë tarifatat të cilat i ngarkojnë shoqëritë pensionale mbi pensionet e anëtarëve të fondeve pensionale, duke siguruar që tarifatat të jenë pasqyrim i një sistemi efikas të sigurimit pensional të financuar me kapital.

Në përputhje me Ligjin për sigurimin pensional të detyrueshëm të financuar me kapital dhe Ligjin për sigurimin pensional vullnetar të financuar me kapital, shoqëritë pensionale ngarkojnë tarifa nga kontributet dhe mjetet si dhe tarifa për kalim. Ngarkimi i tarifave është i domosdoshëm që shoqëritë pensionale të mund të kryejnë funksionet e tyre të lidhura me menaxhimin e fondeve pensionale. Për kryerjen e funksioneve dhe aktiviteteteve të tyre tarifa nga shoqëritë pensionale ngarkojnë edhe kujdestarët e pasurisë, MAPAS dhe Fondi i PIOSM, të cilat në krahasim me vitet fillestare të funksionimit të sistemit janë më të ulëta dhe janë ulur ndjeshëm me rritjen e sistemit. Shuma e tarifës që MAPAS ngarkon nga shoqëritë pensionale u ul përsëri në vitin 2023.

Tarifatat e larta mund të ndikojnë ndjeshëm në vlerën e pensioneve të ardhshme dhe për këtë arsye duhet të mbahen në nivel minimal, gjë që do t'u mundësojë shoqërive pensionale të realizojnë të ardhura të përshtatshme në raport me shpenzimet që ato realizojnë. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ekziston konkurrencë e mjaftueshme ndërmjet shoqërive pensionale (edhe pse në vitin 2022 filloi të punojë edhe një shoqëri e katërt pensionale) për të arritur këto efekte, por edhe përvoja ndërkombëtare tregon se konkurrenca si faktor nuk ka arritur ndikim të konsiderueshëm në uljen e tarifave. Prandaj shumatat maksimale të tarifave përcaktohen me ligj.

Procesi për përcaktimin e lartësisë maksimale të tarifave duhet të jetë objektiv dhe i drejtë për të gjitha palët e përfshira dhe gjatë kësaj duhet të shmangët çdo ndikim politik. Prej këtu rrjedh edhe roli kyç i MAPAS si institucion profesional për të përcaktuar cilat shpenzime janë të domosdoshme për funksionimin e suksesshëm të një shoqërie pensionale dhe për të dhënë këshilla lidhur me uljet e ardhshme të lartësisë maksimale të tarifave. Lartësitë maksimale të tarifave duhet të përcaktohen në një shkallë zbritëse dhe mjaftueshëm paraprakisht për të nxitur kontrolle të rrepta të shpenzimeve të shoqëritë pensionale. Kjo u siguroi me ndryshimet e Ligjit për sigurimin pensional të detyrueshëm të financuar me kapital në vitin 2013, kur u përcaktuan lartësia maksimale e tarifës nga kontributet dhe e tarifës nga mjetet që mund t'i ngarkojnë shoqëritë pensionale në shtyllën e dytë. Tarifa nga kontributet që ngarkojnë shoqëritë pensionale në shtyllën e dytë u ul nga ana e shoqërive pensionale edhe në vitin 2023 dhe 2024 dhe është më e ulët se maksimumi i përcaktuar me ligj.

Gjithashtu edhe në Ligjin për sigurimin pensional vullnetar të financuar me kapital janë përcaktuar lartësitë maksimale të tarifës nga kontributet dhe tarifës nga mjetet që mund t'i ngarkojnë shoqëritë pensionale në shtyllën e tretë. Tarifatat që shoqëritë pensionale realisht i ngarkojnë në shtyllën e tretë janë më të ulëta se maksimumet e përcaktuara me ligj dhe janë ulur nga ana e shoqërive pensionale në disa raste.

MAPAS edhe më tej do të vazhdojë të ndjekë dhe të kontrollojë nëse shpenzimet e krijuara për të cilat paguhet drejtpërdrejt nga anëtarët ose nga të ardhurat e shoqërive pensionale janë ligjore dhe të arsyetuara.

Qëllimi 1.4

Përmirësimi dhe avancimi i kornizës për kryerjen e mbikëqyrjes së shoqërive pensionale, фондеve pensionale dhe kujdestarëve të pasurisë në bazë të vlerësimit të bërë të rreziqeve në sistem.

Që të mund të sigurojë menaxhim të rreziqeve dhe minimizimin e tyre, MAPAS vendosi procese me të cilat identifikohen dhe vlerësohen rreziqet në mënyrë të strukturuar, nga ku merret informacion se çfarë prioriteti dhe çfarë lloj testimi duhet të zbatohet për secilin nga rreziqet dhe çfarë masa shtesë duhet të ndërmerren. Kështu, burimet do të drejtohen drejt atyre rreziqeve për të cilat ekziston një probabilitet i madh që do të ndikojnë në pensionet e ardhshme të anëtarëve dhe në qëndrueshmërinë e sistemit. Po ashtu, burimet do të drejtohen edhe aty ku rreziku ka shtrirjen më të madhe dhe mundësi për t'u zbutur, gjë që do të kontribuojë që MAPAS të përgatisë dhe të propozojë ndryshime me të cilat do të ulëj niveli i rrezikut.

Komiteti për vlerësimin e rreziqeve e koordinon procesin e identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve, ndërsa njëkohësisht, në pjesën e kontrollit në terren dhe jashtë terrenit rishikon dhe propozon përmirësimin e metodave për vlerësimin e rreziqeve.

Në drejtim të forcimit të mbikëqyrjes është miratuar Doracaku për mbikëqyrje të bazuar në rreziqe dhe i njëjti do të rishikohet sipas nevojës.

Qëllimi strategjik 2:

Përparimi dhe mirëmbajtja e një sigurimi pensional të financuar me kapital të qëndrueshëm dhe transparent që e ka mbështetjen e anëtarësisë dhe publikut.

Sigurimi pensional i financuar me kapital përfaqëson një element veçanërisht të rëndësishëm në kuadër të mekanizmave të cilët qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut mund t'u kontribuojnë në sigurimin e sigurisë financiare pas pensionimit të tyre. MAPAS do të vazhdojë t'i ndjekë gjendjet në fushën pensionale, të ndërmarrë aktivitete për përparimin e sigurimit pensional të financuar me kapital dhe të sigurojë kushte për funksionimin efikas të sigurimit pensional të financuar me kapital. Pastaj, MAPAS do të insistojë në implementimin e drejtë të dispozitave të ardhshme ligjore që kanë të bëjnë me multifondet dhe të cilat janë me rëndësi të jashtëzakonshme për optimizimin e portofolëve. Pronarë të fondeve pensionale janë anëtarët dhe pikërisht për këtë arsye është me rëndësi të jashtëzakonshme ekzistimi i përgjegjësisë dhe transparencës si gjatë menaxhimit të fondeve pensionale, ashtu edhe gjatë rregullimit dhe mbikëqyrjes së sigurimit pensional të financuar me kapital. Anëtarët dhe anëtarët e pensionuar duhet të kenë qasje të shpejtë në informacionet që kanë të bëjnë me llogaritë e tyre dhe funksionimin e sistemit.

Sigurimi pensional i financuar me kapital dallon dukshëm nga shtylla e parë që u është e njohur qytetarëve. Është shumë e rëndësishme që anëtarët dhe publiku të kenë një pasqyrë të qartë se si funksionon sigurimi pensional i financuar me kapital dhe cilat janë përfitimet për anëtarët e tij. Qëndrueshmëria e sistemit, në masë të madhe, varet nga mënyra se si ai do të kuptohet nga ana e anëtarësisë dhe publikut, si dhe nga mbështetja që do t'i jepet. MAPAS luan rol kyç në realizimin e këtij qëllimi.

Qëllimi 2.1 Përmirësimi i vazhdueshëm i sigurimit pensional stabil me financim kapital dhe sigurimi i kushteve për funksionim efikas të subjekteve nën mbikëqyrje

Sigurimi pensional me financim kapital si pjesë e sistemit pensional në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka efekte pozitive në drejtim të sigurimit të stabilitetit afatgjatë të sistemit pensional dhe sigurisë në realizimin e të drejtave nga sigurimi pensional. Koncepti i kursimit individual të mjeteve për pension, si një nga burimet e të ardhurave të ardhshme pas pensionimit, ka natyrë afatgjatë, kurse sfidat që sjell sigurimi pensional me financim kapital janë të pashmangshme. MAPAS në vitet e ardhshme do të vazhdojë rregullisht dhe në mënyrë të vazhdueshme t'i ndjekë dhe analizojë gjendjet në fushën pensionale, me çka do të vazhdojë të ndërmarrë edhe aktivitete dhe masa përkatëse për përmirësimin e sigurimit pensional me financim kapital, me qëllim të forcimit të kursimeve individuale për pensionin e ardhshëm përmes promovimit të menaxhimit efikas dhe fleksibël me portofolat dhe sigurimin e kushteve për rritjen e pjesëmarrjes së popullsisë në shtyllën e dytë dhe të tretë.

Të gjitha aktivitetet e drejtuara drejt përmirësimit të sigurimit pensional me financim kapital janë të rregulluara. Si trup rregullator, me kompetenca për të propozuar ligje dhe miratuar akte nënligjore për rregullimin dhe përmirësimin e sigurimit pensional me financim kapital, MAPAS ka rol primar në përmirësimin e sigurimit pensional me financim kapital, dhe me këtë njëkohësisht është e përfshirë në përpjekjet për funksionimin e suksesshëm dhe mbrojtjen e shtetit të së drejtës.

Rregullat janë baza e çdo shteti të së drejtës me çka është përcaktuar rendi i tij juridik, është rregulluar funksionimi i subjekteve dhe marrëdhëniet e tyre të ndërsjella juridike. Për sundimin e së drejtës dhe funksionimin konsekuent të shtetit si shtet i së drejtës, parakusht bazë janë rregullat përmbajtësore përkatëse, juridikisht të bazuara dhe të rregulluara drejtë në aspektin nomoteknik. Përmbajtja e rregullës duhet të jetë e kuptueshme, e paekuivoke, e përdorshme dhe e zbatueshme. Një nivel i tillë i rregullave mund të arrihet vetëm nëse rregullat janë të përgatitura në mënyrë nomoteknike përkatëse dhe juridikisht të sakta, që do të thotë, se duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, të jenë të miratuara nga organet kompetente dhe sipas procedurës së paraparë. Gjatë zbatimit në praktikë, rregulla e përgatitur keq shkakton një sërë vështirësish dhe problemesh dhe e zvogëlon sigurinë juridike dhe besimin te e drejta dhe shteti i së drejtës.

Në këtë drejtim MAPAS në vitet e ardhshme do të vazhdojë të kryejë kompetencat e saj rregullatore, gjegjësisht të propozojë dhe miratojë rregulla në sigurimin pensional me financim kapital, në bazë të:

- ndjekjes së proceseve dhe gjendjeve aktuale në sigurimin pensional me financim kapital, në sistemin pensional dhe në sektorin financiar në shtet,
- ndryshimeve të ligjeve nga fushat e tjera (shoqëritë tregtare, kundërvajtjet, digjitalizimi, mbrojtja e të dhënave personale, parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit etj.)
- harmonizimit me të drejtën (acquis) e BE-së dhe
- përvojave, praktikave dhe rekomandimeve ndërkombëtare (BB, IOPS, OECD, FSAP etj.)

Gjithashtu, MAPAS do të vazhdojë të propozojë ndryshime edhe të ligjeve në fusha të tjera të cilat kanë ndikim në stabilitetin dhe përmirësimin e sigurimit pensional me financim kapital.

Shoqëritë pensionale dhe fondet pensionale janë themeluar dhe punojnë në bazë të miratimit/pëlqimit nga MAPAS në procedurë të rregulluar dhe kushte të rrepta. Me qëllim të mbajtjes së kushteve për funksionim efikas të shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale si dhe të ruajtësve të pasurisë, MAPAS do të vazhdojë të zbatojë procedurat për miratimin e dokumenteve dhe personave (anëtarë të bordit drejtues dhe mbikëqyrës dhe persona përgjegjës për fusha të caktuara) të cilët kanë qenë të miratuar në procedurën për licencim, kurse është e nevojshme të ndryshohen.

Në vitin 2020 MAPAS u përfshi në angazhimin e përbashkët me rregullatorët financiarë, të udhëhequr nga BPRMV, për identifikimin me kohë dhe efikas të rreziqeve sistematike dhe ndërmarrjen e aktiviteteve për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit të tyre mbi sistemin financiar. Në gusht të vitit 2022, hyri në fuqi Ligji për Stabilitet Financiar me çka u vendos korniza institucionale për pozicionimin e politikës makroprudenciale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kurse në prill të vitit 2023 u miratua Strategjia për zbatimin e politikës makroprudenciale në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Me ligjin, juridikisht institucionalizohet Komiteti për Stabilitet Financiar dhe iu ndanë kompetenca rregullatorëve të sistemit financiar. Me Strategjinë për zbatimin e politikës makroprudenciale në Republikën e

Maqedonisë së Veriut u vendos korniza operative për zbatimin e politikës makroprudenciale nga ana e Komitetit për Stabilitet Financiar dhe rregullatorëve kompetentë. Me këto aktivitete gjithashtu, do të jetë e përforcuar plotësisht qëndrueshmëria e sistemit financiar ndaj shokëve, kurse institucionet kompetente do të jenë edhe më të përgatitura për menaxhimin e sfidave. MAPAS në vitet e ardhshme do të punojë në ndërtimin e kapacitetit të saj për zbatimin e këto aktiviteteve si dhe për aktivitetet në drejtim të zbatimit të politikës makroprudenciale, përcaktimin e instrumenteve makroprudenciale dhe ndërmarrjen e masave makroprudenciale ndaj subjekteve mbi të cilët kryen mbikëqyrje.

Zhvillimi ekspansiv i teknologjisë shpejt po transformon mënyrën në të cilën funksionon sektori financiar, duke përfshirë edhe sektorin pensional. Duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë e sigurimit pensional me financim kapital, disa nga teknologjitë inovative (si aplikacionet celulare dhe platformat interaktive ose njoftimet digjitale) mund ta lehtësojnë qasjen deri te informacionet kyçe pensionale në kohë reale dhe njëkohësisht t'u mundësojnë të siguruarve më mirë t'i planifikojnë dhe menaxhojnë kursimet e tyre pensionale. Prandaj, në vitet e ardhshme MAPAS do t'i orientojë aktivitetet e saj edhe drejt përpjekjeve për të shfrytëzuar teknologjinë për të përmirësuar cilësinë dhe „dërgimin" e shërbimeve dhe informacioneve nga shoqëritë pensionale dhe si rregullator do t'i nxisë dhe mbështesë këto ndryshime. Si aktivitet fillestar në këtë drejtim, duke pasur parasysh kapacitetet dhe resurset e tanishme të MAPAS, është përfshirja në aktivitete që do të dalin nga qendra për inovacione që e vendosi BPRMV. Pastaj, MAPAS do të jetë aktivisht e përfshirë edhe në aktivitetet e përbashkëta me pjesëmarrësit dhe rregullatorët e tjerë në sektorin financiar, e që i udhëheq BPRMV dhe janë në drejtim të rritjes së vetëdijes për rëndësinë e teknologjive të reja, rreziqet dhe përfitimet nga aplikimi i tyre, në sigurimin pensional me financim kapital si pjesë e sektorit financiar. Me nënshkrimin e Memorandumit për bashkëpunim të rregullatorëve financiarë për krijimin e kushteve për mbështetjen e zhvillimit të inovacioneve në sistemin financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut u formua Komiteti për mbështetjen e zhvillimit të inovacioneve në sistemin financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në prill të vitit 2023 Komiteti për mbështetjen e zhvillimit të inovacioneve në sistemin financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut (Komiteti për fintech-sektorin) miratoi Strategjinë për rregullatorët për fintech-sektorin, e cila ka për qëllim të sigurojë kushte për mbështetjen e inovacioneve në fushën e financave, duke pasur parasysh mbrojtjen e konsumatorëve dhe investitorëve dhe stabilitetin e sistemit financiar.

Paralelisht, lind edhe nevoja për detektimin e rreziqeve që mund të krijohen për shkak të zhvillimit të teknologjive financiare, si për shembull sulmet kibernetike, keqpërdorimi i mjeteve pensionale, marrja e të dhënave personale dhe informacioneve etj. Prandaj, inovacionet në sigurimin pensional me financim kapital duhet të jenë fushë e vëmendjes së shtuar të mbikëqyrjes. Pastaj, teknologjitë inovative kanë potencial ta thjeshtojnë dhe ta përmirësojnë edhe funksionin rregullator dhe mbikëqyrës, përmes rritjes së efikasitetit të procedurave administrative, lehtësimit të komunikimit ndërmjet subjekteve të mbikëqyrura dhe mbikëqyrësve, racionalizimit të proceseve për raportim dhe automatizimit të proceseve për mbledhjen e të dhënave, automatizimit të analizave të të dhënave të mbledhura, zhvillimit të platformave teknologjike për lehtësimin e mbikëqyrjeve në terren etj.

Në këtë drejtim të zhvillimit të teknologjisë dhe ndikimit mbi sektorin pensional është e domosdoshme përforcimi i njohurive ekzistuese, sigurimi i ekspertizës dhe i alateve teknologjike dhe zgjidhjeve për zhvillimin e projekteve digjitalë në MAPAS.

Qëllimi 2.2

Krijimi dhe promovimi i portofolave të ndryshëm investues në bazë të moshës së anëtarëve të fondeve pensionale dhe të gjitha mundësive që do t'i kenë anëtarët gjë që, nga ana tjetër, do të mundësojë vendosjen e multifondeve

Për momentin çdo shoqëri pensionale menaxhon me nga një fond pensional të detyrueshëm dhe me nga një fond pensional vullnetar. Parimi i njeriut të arsyeshëm kërkon që fondet pensionale të jenë përkatësisht të optimizuara për të mundur t'u përshtaten rrethanave specifike të çdo anëtari. Më konkretisht, kohëzgjatja optimale e instrumenteve financiare varet nga koha e mbetur deri në pensionim, si dhe nga shkalla në të cilën anëtarët mund të jenë të ekspozuar ndaj luhatshmërisë së tregut pa pësuar humbje të cilat nuk do të mund të kompensoheshin para periudhës për pensionim. Në fakt, probabiliteti që luhatshmëria e tregut do të mund të shkaktonte ndikim serioz mbi mjetet e akumuluar të anëtarëve para vetë pensionimit, paraqet një nga nxitësit për planifikimin e investimit sipas periudhës së pensionimit të anëtarëve. Zgjidhja ndërkombëtarisht më e pranuar dhe më e rekomandueshme për atë problem është investimi strategjik i mjeteve të anëtarëve i udhëhequr nga koha e mbetur deri në pensionim (ndjekja e ciklit jetësor).

Në atë kuptim, praktika tregon se vendimet për ndryshim në investimin e mjeteve janë të lidhura me moshën, që nuk do të thotë domosdoshmërisht se edhe do t'u përgjigjen rrethanave specifike të anëtarit. Prandaj, zakonisht, jepet mundësia që anëtari të zgjedhë portofolin, që të mund t'i shmangë vendimet për investimin e mjeteve të cilat, në të kundërtën, do t'i imponoheshin mjeteve të tij.

Në vendet me sistem të ngjashëm me sistemin pensional maqedonas, "multifondet" përdoren si metodë standarde për investim sipas ciklit jetësor me të cilin u jepet mundësia anëtarëve për zgjedhje. Kështu, edhe në sigurimin pensional me financim kapital të detyrueshëm edhe në atë vullnetar do të mundësohet ekzistimi i tre portofolave pensionalë që do të dallohen sipas mënyrës së investimit të mjeteve dhe, në përputhje me këtë, anëtarët e fondit pensional do të mund të zgjedhin një portofol pensional. Njëkohësisht, struktura e anëtarësisë imponon nevojën për vendosjen e multi fondeve në bazë të portofolave të ndryshëm (rritës, i balancuar dhe konservator) sipas strukturës moshore të anëtarëve.

Anëtarët të cilët nuk do të zgjedhin vetë portofolin do të rishpërndahen automatikisht në portofolin që do t'i përgjigjet moshës së tyre. Pas ndryshimit të ligjeve përkatëse dhe akteve nënligjore, do të vijë periudha kalimtare për shkak të harmonizimit të investimit të mjeteve. Qëllimi i vendosjes së tre llojeve të portofolit është të rritet pensioni i ardhshëm nga shtylla e dytë pensionale, të përmirësohet siguria gjatë investimit të mjeteve duke pasur parasysh kushtet e ndryshueshme të rrezikut, sigurinë dhe likuiditetin adekuat të fondeve pensionale gjatë rrugëtimit jetësor të anëtarëve dhe rritjen e diversifikimit të mundësive për investim.

MAPAS, shoqëritë pensionale dhe ruajtësit e pasurisë do të forcojnë kapacitetin e tyre që të mund t'i implementojnë multifondet. MAPAS do të kryejë kontroll mbi shkallën e zhvillimit të kapaciteteve të shoqërive për të përcaktuar nëse ato janë në nivel të kënaqshëm dhe nëse janë në përputhje me funksionin që kryejnë. Njëkohësisht, MAPAS do të kontrollojë edhe menaxhimin me rreziqet që i kanosen sistemit, e që rrjedhin nga vetë vendosja e multifondeve. Në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, MAPAS do të kujdeset për implementimin përkatës të kësaj risie, duke përfshirë edhe përgatitjen e rregulloreve përkatëse.

Qëllimi 2.3

Sigurimi i vazhdueshëm i transparencës së sigurimit pensional me financim kapital dhe shpjegimi i karakteristikave, mundësive dhe avantazheve të sigurimit pensional me financim kapital, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për qytetarët

Gjatë ekzistimit të sistemit pensional me tre shtylla, kurse sipas hulumtimeve të zbatuara të opinionit publik të anëtarëve të fondeve pensionale konstatohet një lëvizje e caktuar pozitive e nivelit të njohjes së përgjithshme të publikut për karakteristikat dhe avantazhet e sigurimit pensional me financim kapital dhe për rolin që MAPAS ka në sistemin pensional. Megjithatë, për MAPAS si rregullator dhe mbikëqyrës mbetet edhe më tej perceptimi i saktë se ky nivel i vetëdijes publike nuk është i mjaftueshëm veçanërisht sepse personat kanë rol personal përmes marrjes së vendimeve gjegjësisht përgjithësisht kanë të drejtë dhe liri të zgjedhjes, në të gjitha fazat e kursimit pensional - anëtarësim, akumulim dhe pagesë. Në vitin 2020 kur bota u ballafaqua me pandeminë me virusin korona dhe krizën globale financiare, nevoja për vetëdije më të madhe të publikut u theksua edhe më shumë. Gjithashtu, rrethina e re dikton edhe zhvillim të përshpejtuar të teknologjisë e cila shpejt po transformon mënyrën në të cilën funksionon sektori financiar, duke përfshirë edhe sektorin pensional që do të mundësojë qasje më të thjeshtë deri te sigurimi pensional me financim kapital nga njëra anë por edhe nevojë të rritur për edukim nga ana tjetër.

Prandaj, zhvillimi i vetëdijes së publikut për qëllimet dhe parimet e sigurimit pensional me financim kapital mbetet edhe më tej një nga sfidat kryesore të MAPAS. Ngritja e vetëdijes së publikut dhe rritja e mbështetjes për sigurimin pensional me financim kapital në kuadër të sistemit pensional do ta mbështesë përmirësimin e sistemit, kurse njëkohësisht do të zvogëlojë edhe probabilitetin që të shfaqen situata të paparashikuara në afat më të gjatë. Roli i MAPAS, i cili është i rregulluar me ligj dhe nënkupton përgjegjësi për aktivitetet e veta, i mundëson MAPAS të marrë rolin udhëheqës në rritjen e nivelit të vetëdijes publike.

MAPAS siguron publikimin dhe ndarjen e rregullt dhe me kohë të të dhënave të detajuara dhe informacioneve për sigurimin pensional me financim kapital përmes raporteve për gjendjet në sigurimin pensional me financim kapital dhe raporteve statistikore. Me këtë sigurohet transparenca e sigurimit pensional me financim kapital dhe bazë e mirë për ndarjen e mëtejshme të informacioneve përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit. Në vitin 2023, të dhënat statistikore për sigurimin pensional me financim kapital janë të qasshme për publikun edhe përmes alatit të ri për të dhëna statistikore "MAPAS-STAT" i cili siguron qasje bashkëkohore

dhe të thjeshtë deri te të dhënat, mundësi për filtrim të pavarur të të dhënave, përgatitje të serive kohore, vizualizim interaktiv dhe shkarkim të të dhënave si dhe vëllim të rritur dhe frekuencë të publikimit të të dhënave relevante statistikore. MAPAS në vitet e ardhshme do të vazhdojë të punojë në përmirësimin e raporteve për sigurimin pensional me financim kapital si përmes përmirësimit cilësor dhe sasior të të dhënave ashtu edhe përmes mundësimit të qasjes më të thjeshtë deri te këto të dhëna për pjesëmarrësit, të gjitha palët e interesuara dhe publikun e gjerë.

MAPAS, në kuadër të kompetencave të veta për zhvillimin e vetëdijes së publikut për qëllimet dhe parimet e sigurimit pensional me financim kapital dhe të drejtat e anëtarëve të fondeve pensionale, do të vazhdojë të kryejë edukimin e anëtarëve dhe publikut, e veçanërisht të personave të rinj, me qëllim të rritjes së vetëdijes dhe informimit të të siguruarve për sistemin. Gjithashtu, MAPAS do të vazhdojë të punojë edhe në përmirësimin e aktiviteteve që do të kontribuojnë për rritjen e vetëdijes pensionale te publiku, duke i përshtatur ato me grupet e synuara, trendet dhe risitë e nxitura nga zhvillimi i teknologjisë në komunikimin me publikun.

Nga viti 2016 MAPAS filloi ta shënojë "Ditën për vetëdije pensionale 15 shtator" përmes organizimit të konferencave para trupave rregullatorë, institucioneve shtetërore, bashkëpunëtorëve dhe mysafirëve nga vendi dhe jashtë, si dhe përmes ngjarjeve informative argëtuese. Nga viti 2019, MAPAS filloi me zbatimin e fushatës informative për edukimin dhe informimin e anëtarëve të fondeve pensionale për sistemin pensional. MAPAS edhe në të ardhmen do të vazhdojë me organizimin e aktiviteteve për shënimin e ditës për vetëdije pensionale dhe zbatimin e fushatave informative. Pastaj, një pjesë e aktiviteteve për informimin e publikut do të zbatohen me angazhim të përbashkët edhe të shoqërive pensionale. Gjithashtu, një pjesë të aktiviteteve MAPAS do t'i orientojë drejt promovimit të rëndësisë dhe rolit të MAPAS.

Nga dhjetori i vitit 2013 MAPAS është aktivisht e përfshirë edhe në angazhimin e përbashkët të institucioneve rregullatore financiare në lidhje me edukimin financiar, si pjesë e Trupit Koordinues për edukim financiar dhe inkluzion financiar. MAPAS në vitet e ardhshme do të vazhdojë të marrë pjesë në punën dhe aktivitetet e shumta të këtij trupi, që përfshin edhe pjesëmarrje në zbatimin e Strategjisë së parë nacionale për edukim financiar dhe inkluzion financiar për periudhën prej vitit 2021-2025 që duhet të kontribuojë për ndërtimin e mëtejshëm të kapaciteteve për zhvillimin e edukimit financiar dhe përmirësimin e mëtejshëm të përfshirjes financiare të popullsisë. Në vitin 2023 filloi faza e dytë e Projektit për pjekuri financiare me INFE-OECD, së bashku me Ministrinë e Financave të Holandës dhe platformën Money Wise i cili do të zgjasë në periudhën prej vitit 2023-2027. Prioriteti kryesor i këtij projekti është të mbështesë vendet të cilat janë pjesë e të njëjtit (Maqedonia e Veriut, Bosnja e Hercegovina, Bullgaria, Gjeorgjia, Armenia, Moldavia, Rumania, Ukraina, Kroacia dhe Mali i Zi), të ngrerë nivelin e pjekurisë financiare te popullsia përmes mbështetjes dhe implementimit të strategjive dhe politikave për pjekuri financiare, me sigurimin e analizave, raporteve dhe rekomandimeve për ndërtimin e kapaciteteve sipas nevojave institucionale dhe prioriteteve strategjike të vendeve.

Duke pasur parasysh se edhe pas më shumë se pesëmbëdhjetë viteve punë në shtyllën e tretë dhe fillimit të punës edhe të fondit të katërt pensional vullnetar në vitin 2022, pjesëmarrja e popullsisë në shtyllën e tretë, ende, nuk i ka arritur pritshmëritë, MAPAS në vitet e ardhshme do t'u kushtojë vëmendje të veçantë aktiviteteve për promovim për shkak të rritjes së pjesëmarrjes në shtyllën e tretë, kurse njëkohësisht në atë drejtim do t'i nxisë edhe shoqëritë pensionale.

Përveç kësaj, në periudhën e ardhshme MAPAS do të angazhohet për mundësimin e rregullave të thjeshtuara dhe kufizimeve të zvogëluara për përfshirjen e popullsisë në fondet pensionale vullnetare si në bazë të iniciativës personale ashtu edhe përmes iniciativave të punëdhënësve ose shoqatave të qytetarëve si sponsorë të skemave pensionale profesionale.

MAPAS edhe në të ardhmen do të kontribuojë për ngritjen e vetëdijes së publikut dhe për përmirësimin e të kuptuarit për sistemin, si dhe promovimin e sigurimit pensional me financim kapital vullnetar.

Qëllimi 2.4

Përmirësimi i cilësisë së informacioneve që u dërgohen anëtarëve të fondeve pensionale në lidhje me të drejtat, detyrimet dhe interesat e tyre, me qëllim që të ndërtojë besim në sistem dhe në mënyrë transparente dhe efikase t'i plotësojë kërkesat e anëtarëve

Hulumtimet e zbatuara të opinionit publik dhe komunikimi i përditshëm me anëtarët e fondeve pensionale dhe publikun tregojnë se ekziston një lëvizje e caktuar pozitive e nivelit të njohjes për sigurimin pensional me financim kapital dhe sistemin pensional gjatë viteve të ekzistimit të sistemit pensional me tre shtylla. Megjithatë MAPAS vlerëson se njohja e pjesës më të madhe të anëtarëve të fondeve pensionale është ende në nivel i cili nuk është përkatës dhe se kjo mund të kontribuojë që anëtarët të jenë të ekspozuar ndaj konkluzioneve të gabuara në lidhje me pensionet e tyre të ardhshme, që mund të çojë deri te vendimet që nuk janë optimale dhe zhgënjime të pajustificuara. Gjithashtu, vlerësohet se anëtarët ende nuk dinë çfarë të presin nga shoqëritë e tyre pensionale, çfarë mbrojtjeje është paraparë për pensionet e tyre të ardhshme, as se kush është përgjegjës për ta siguruar atë. Pikërisht për këtë shkak, roli i MAPAS është të kontribuojë që anëtarët ta kuptojnë drejtë sigurimin pensional me financim kapital.

MAPAS do të vazhdojë me kujdes ta ndjekë njohjen e anëtarëve për të drejtat dhe detyrimet e tyre, do të vazhdojë të sigurojë kushte për përmirësimin e cilësisë së informacioneve dhe për përforcimin e kanaleve të komunikimit deri te anëtarët. MAPAS do të vazhdojë të sigurojë informacione për personat të cilët janë tashmë anëtarë dhe atë drejtpërdrejt në kërkesën e tyre, duke përfshirë edhe informacione për shpërndarjen e tyre në fond pensional të detyrueshëm.

MAPAS siguron veprim të rregullt dhe me kohë sipas parashtresave (ankesa, kundërshtime, kërkesa) të anëtarëve sipas bazave të ndryshme. Me këtë sigurohet veprim efikas sipas kërkesave të anëtarëve të fondeve pensionale që kontribuon drejt rritjes së besimit në sistem. MAPAS do të vazhdojë edhe në të ardhmen rregullisht dhe me kohë të veprojë sipas parashtresave të anëtarëve të fondeve pensionale. MAPAS do të përfshihet edhe në aktivitete për mbrojtjen e konsumatorëve në kuadër të grupit të punës të MF.

Aktivitetet për marketing dhe shitje të shoqërive pensionale gjithashtu ndikojnë në përmirësimin e të kuptuarit të sigurimit pensional me financim kapital te anëtarët dhe anëtarët potencialë, por

ato aktivitete, nëse nuk janë të rregulluara dhe kontrolluara mirë, mund t'i çojnë qytetarët në mashtrim gjë që, mund të ndikojë në zvogëlimin e besimit në sistem. Prandaj, MAPAS do të vazhdojë të sigurojë kushte në të cilat shoqëritë pensionale me sukses do t'i zbatojnë dhe kontrollojnë aktivitetet e tyre të marketingut dhe do të sigurojë zgjidhjen e problemeve që do të shfaqen. Gjithashtu, MAPAS, do të vazhdojë të kontrollojë mënyrën në të cilën shoqëritë pensionale komunikojnë me anëtarët, veçanërisht në fazën e dhënies së informacioneve kur anëtarët qasen drejt ndonjë fondi pensional.

Qëllimi 2.5

Mirëmbajtja e rregullt dhe përditësimi i regjistrit të anëtarëve të fondeve pensionale të detyrueshme

Një nga punët që kryen MAPAS, në përputhje me rregullativën, është mbajtja e regjistrit të anëtarëve dhe regjistrit të anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale të detyrueshme. Në këtë kuptim, në vitet e kaluara të funksionimit të sistemit janë konstatuar disa mospërputhje/mungesa në të dhënat e anëtarëve të shtyllës së dytë nga aspekti i përditësimit të tyre jo të rregullt nga vetë të siguruarit ose për shkak të paplotësisë së evidencave të të dhënave të institucioneve të tjera të përfshira prej nga merren një pjesë e të dhënave të anëtarëve. Të siguruarit dhe popullata në përgjithësi sillen në mënyrë inerte në lidhje me reagimin e tyre me kohë për përditësimin e të dhënave të tyre personale, gjë që me shumë gjasa është rezultat i nivelit ende relativisht të ulët të "pjekurisë dhe kulturës pensionale" të mbarë popullatës dhe sigurisht i motivimit të dobët për përditësim me iniciativë personale të të dhënave personale të ndryshuara. Gjithashtu, një pjesë e institucioneve që janë të përfshira në ndarjen e të dhënave, për një sërë arsyesh, shpesh kanë evidencat të paplota. Kjo ndikon negativisht në qasjen tek anëtarësia dhe vështirëson komunikimin e MAPAS dhe shoqërive pensionale me anëtarët në shtyllën e dytë, gjë që në fund implikon edhe nivelin e pashpresë të informimit të anëtarëve.

Sistemi gradualisht "piqet" përmes rritjes së përfshirjes së popullsisë dhe përmes rritjes së vazhdueshme të mjeteve të fondeve pensionale të detyrueshme, me çka rëndësia e sigurimit pensional me financim kapital rritet. Me këtë potencohet rëndësia e mirëmbajtjes së të dhënave të përditësuara dhe komplete, si nga aspekti i rolit personal të individit, ashtu edhe për shkak të vetëdijes së përgjithshme të publikut dhe mbështetjes së sistemit. Pastaj, edhe përkundër faktit se pritet që në vitet e ardhshme një numër i vogël i anëtarëve të fondeve pensionale të detyrueshme do të plotësojnë kushtet për pensionim, MAPAS në periudhën e ardhshme do të orientohet drejt vendosjes së plotë, mbajtjes dhe përditësimit të regjistrit të anëtarëve të pensionuar.

Në drejtim të mirëmbajtjes dhe përmirësimit të qasjes tek anëtarësia, MAPAS do të zbatojë dhe do të iniciojë aktivitete për përmirësimin e proceseve për përditësimin e të dhënave dhe do të kërkojë përmirësimin e evidencave të të gjitha institucioneve që kanë të dhëna burimore për të siguruarit.

Gjithashtu në vitet e ardhshme MAPAS do të vazhdojë me aktivitetet për verifikimin dhe kontrollin e të dhënave për anëtarësimin në fondet pensionale vullnetare që merren nga shoqëritë pensionale. Këto aktivitete janë në drejtim të sigurimit të përmbushjes së kërkesave dhe rregullave që lidhen me përfshirjen e anëtarëve në shtyllën e tretë, si dhe pasqyrën e plotë, ndjekjen aktuale dhe analizimin e gjendjes me anëtarët në fondet pensionale vullnetare.

Qëllimi 2.6

Garantimi i vërtetësisë dhe konsistencës së bazës së të dhënave

MAPAS ka rol domethënës në mirëmbajtjen e bazave të të dhënave në të cilat shënohen të gjitha të dhënat për anëtarët e fondeve pensionale. Mirëmbajtja e bazave të të dhënave kontribuon për vërtetësinë e të dhënave dhe siguron sigurinë e çdo anëtari se mund t'i ndjekë kontributet që paguhet në llogarinë e tij individuale. Këto të dhëna, njëkohësisht, do të duhej t'i mundësonin MAPAS-it t'i verifikojë të dhënat që përdorin shoqëritë pensionale gjatë kryerjes së funksioneve të tyre, siç është komunikimi me anëtarët, ndërsa të dhënat e shoqërive pensionale mund të përdoren për verifikimin e të dhënave që mban MAPAS.

Deri më tani nuk janë vërejtur probleme domethënëse me evidencën e të dhënave për anëtarësimin të shkaktuara nga incidentet në sistemin informatik (nga aspekti teknik ose për shkak të faktorit njeri), por duke pasur parasysh faktin se anëtarësia dhe mjetet edhe më tej do të vazhdojnë të rriten dhe të pihen, MAPAS do të ballafaqohet me sfida serioze për të garantuar se të dhënat në sistemin janë të vërteta dhe konsistente. Prandaj, ky detyrim në pesë vitet e ardhshme dhe në të ardhmen do të përfaqësojë prioritet të lartë për MAPAS.

Në të ardhmen MAPAS do ta përmirësojë perspektivën e TI-së edhe në kontrollin në terren dhe atë jashtë terrenit që e zbaton me qëllim që të forcohet sukcesi i mbikëqyrjes në të ardhmen.

Qëllimi 2.7

Sigurimi i kushteve për zbatimin e papenguar të pagesës së pensioneve dhe kompensimeve pensionale anëtarëve të pensionuar dhe promovimi i proceseve të cilësisë së lartë lidhur me pagesën e pensioneve dhe kompensimeve pensionale

Gjatë vendosjes së sistemit të sigurimit pensional me financim kapital prioritet ishte zhvillimi i mekanizmave për akumulimin e mjeteve për pension, kurse pas pothuajse një dekade nga fillimi i punës së fondeve pensionale u zhvilluan dhe u rregulluan edhe mekanizmat për pagesën e pensioneve nga shtylla e dytë dhe e tretë. Qëllimi është që anëtarët e fondeve pensionale gjatë pensionimit të kenë mundësi zgjedhjeje ndërmjet tërheqjeve të programuara që do t'i sigurojnë shoqëritë pensionale, anuiteteve që do t'i sigurojnë shoqëritë për sigurimin e jetës ose kombinimit të tyre.

Në periudhën e kaluar nga miratimi i akteve ligjore dhe nënligjore, faza e pagesës së pensioneve dhe kompensimeve pensionale ishte pjesërisht e implementuar, sepse anëtarët e fondeve pensionale janë ende relativisht të rinj dhe vetëm një pjesë shumë e vogël e anëtarëve në fondet pensionale të detyrueshme realizuan pensione ose pagesa nga shtylla e dytë. Pastaj, me ndryshimet e Ligjit për sigurimin pensional me financim kapital të detyrueshëm të dhjetorit të vitit 2018 që u referoheshin ndryshimit të kriterit për anëtarësim në fondet pensionale të detyrueshme, në vitin 2019 numrit më të madh të anëtarëve më të moshuar për të cilët anëtarësimi në shtyllën e dytë doli se nuk është i volitshëm, u pushoi anëtarësimi, dhe këta të siguar mbeten të siguar vetëm në sigurimin pensional me financim aktual të bazuar në solidaritetin gjeneratash. Kjo gjendje mundësoi vazhdimin e kornizës kohore të pritur për fillimin e pagesës së pensioneve për një pjesë më domethënëse të anëtarëve në fondet pensionale të detyrueshme. Por, edhe përkundër faktit se pritet që në vitet e ardhshme një numër i vogël i anëtarëve të fondeve pensionale të detyrueshme do të plotësojnë kushtet për pensionim, përsëri MAPAS duhet në vitet e ardhshme të promovojë procese të cilësisë së lartë për pagesën e pensioneve dhe kompensimeve pensionale. Shërbimi me kohë dhe cilësor për pagesën e pensionit nga shtylla e dytë për anëtarët të cilët në dhjetë vitet e ardhshme do t'i realizojnë kushtet për pension përfaqëson faktor të rëndësishëm për mirëmbajtjen e reputacionit dhe besimit të qytetarëve në sigurimin pensional me financim kapital.

Bashkë me shoqëritë pensionale, Fondin e SPIM-it dhe AMS-në, MAPAS do të sigurojë implementimin e sigurt dhe të plotë të fazës së pagesës së pensioneve duke siguar që të gjitha procedurat e nevojshme janë vendosur. Kjo do të thotë se për anëtarët do të duhet të jenë të vendosur sistemet dhe burimet e informatave përmes të cilave ata do të mund të bëjnë zgjedhjen e vërtetë që do t'u përgjigjet nevojave dhe gjendjeve të tyre. Kjo nënkupton që faza e pagesës së pensioneve do të jetë e harmonizuar me zhvillimin e tregut për anuitetet pensionale, përmirësimin e sigurimit të tërheqjeve të programuara dhe proceseve të vendosura për kontrollin e pagesave të mjeteve nga llogaritë e anëtarëve.

Paralelisht me aktivitetet për sigurimin e kushteve për zbatimin e papenguar të pagesës së pensioneve, po zhvillohen edhe aktivitete lidhur me pagesën e kompensimeve pensionale. Në lidhje me shtyllën e tretë, MAPAS në vitet e ardhshme pret numër më të madh anëtarësh nga

fondet pensionale vullnetare (relativisht ndaj gjendjes së tyre të përgjithshme) të cilët do t'i plotësonin kushtet për pagesë të kompensimeve pensionale, gjë që gjithashtu përfaqëson parakusht domethënës në angazhimin e rritur për sigurimin e shërbimit cilësor dhe me kohë lidhur me pagesën nga shtylla e tretë.

Qëllimi Strategjik 3:

Përmirësimi i kapacitetit në drejtim të forcimit të rolit të saj mbikëqyrës dhe rregullator në sigurimin pensional me financim kapital

Kapaciteti i MAPAS është shumë domethënës për rregullimin e mirë dhe mbikëqyrjen efikase të sigurimit pensional me financim kapital. Për ta zhvilluar kapacitetin e vet, MAPAS në periudhën që është e përfshirë me Planin Strategjik do të orientohet drejt disa fushave kryesore. Menaxhimi me burimet njerëzore do të jetë një nga çështjet kyçe zgjidhja e të cilave do të ndihmojë që MAPAS të përmirësohet në një organizatë më profesionale dhe më të specializuar. Planet për trajnim do të jenë të dizajnuara dhe të përgatitura për ta përmirësuar kapacitetin si të punonjësve, ashtu edhe të ekipit drejtues. Gjithashtu, MAPAS do të menaxhojë me të dhënat në mënyrë më profesionale në përputhje me nevojat e sistemit dhe do t'i mirëmbajë zgjidhjet për mirëmbajtjen e vazhdimësisë së biznesit dhe rikuperimit në rast katastrofe (katastrofa natyrore dhe të tjera). Pastaj, MAPAS në mënyrë të vazhdueshme do t'i përmirësojë të gjitha proceset, procedurat dhe sistemet me qëllim që ta përmirësojë efektivitetin e vet të biznesit. Gjithashtu, MAPAS në vitet e ardhshme do të punojë në ndërtimin e kulturës në të cilën menaxhimi dhe komunikimi për rreziqet e përcaktuara në punë do të bëhet praktikë mbi bazën e së cilës do të merren vendime përkatëse. MAPAS në mënyrë të vazhdueshme do ta mirëmbajë bashkëpunimin me pjesëmarrësit në sistem si në Maqedoninë e Veriut, ashtu edhe jashtë vendit, në drejtim të përmirësimit të mësimin të përbashkët dhe zhvillimit të sigurimit pensional me financim kapital. MAPAS do ta mirëmbajë stabilitetin financiar duke siguruar menaxhim efikas me financat. MAPAS do ta përmirësojë menaxhimin e vet, planifikimin, transparencën dhe përgjegjësinë shoqërore.

Qëllimi 3.1

Ndërtimi i vazhdueshëm i profesionalizmit dhe ekspertizës së organit drejtues dhe punonjësve

Profesionalizmi dhe ekspertiza e organit drejtues dhe punonjësve janë faktorë kyç që kontribuojnë për përmirësimin e kapacitetit të MAPAS për shkak të sigurimit të funksionalitetit më të mirë dhe shërbimit publik. Mënyra më e mirë për ndërtimin e profesionalizmit dhe ekspertizës është përmes menaxhimit me burimet njerëzore. Përmes menaxhimit përkatës dhe të mirëpërcaktuar me burimet njerëzore mund të vendosen strategji dhe të zhvillohen politika, standarde, sisteme dhe procese përmes të cilave do të zbatohen ato strategji në pothuajse të gjitha fushat. Në pesë vitet e ardhshme MAPAS do të vazhdojë ta përmirësojë menaxhimin me burimet

njerëzore, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të potencialit njerëzor që do të kontribuojë për forcimin e kapacitetit të MAPAS.

MAPAS do të vazhdojë ta planifikojë rritjen e burimeve njerëzore në bazë të analizës me çka do të konstatohet gjendja ekzistuese dhe nevoja për përfshirjen e kuadrove të reja dhe për këtë do të miratojë Planin Vjetor për punësim.

MAPAS në vitet e ardhshme do të vazhdojë të mundësojë zhvillimin e shkathtësive profesionale, teknike dhe sociale të punonjësve përmes trajnimeve të specializuara dhe gjenerike, për çka do të miratojë Planin Vjetor për trajnimin e punonjësve në MAPAS në përputhje me Programin për trajnimin e nëpunësve administrativë në Republikën e Maqedonisë së Veriut si dhe Planin për trajnime të specializuara për çdo punonjës individualisht. Kjo, njëkohësisht, do të kontribuojë edhe për zhvillimin e vazhdueshëm të kompetencave të punonjësve, shfrytëzimin më të mirë të burimeve njerëzore, si dhe për motivimin e punonjësve.

MAPAS gjithashtu do të punojë edhe në përmirësimin e procesit të vlerësimit të punonjësve, gjë që do të kontribuojë për ndjekjen përkatëse të kapaciteteve aktuale të MAPAS dhe ndërmarrjen e aktiviteteve përkatëse të orientuara drejt përmirësimit të kapaciteteve të MAPAS.

MAPAS në punën e vet do të vazhdojë të sigurojë nivelin më të lartë të sjelljes profesionale dhe etike përmes ndjekjes së standardeve nga Kodi i etikës profesionale të punonjësve dhe nga Kodi i etikës profesionale të punonjësve gjatë kryerjes së mbikëqyrjes në terren dhe jashtë terrenit, si dhe nga Kodi për nëpunësit administrativë. Organi drejtues i MAPAS do t'i ndjekë edhe standardet nga Kodi për sjellje etike për anëtarët e Qeverisë dhe bartësit e funksioneve publike të emëruar nga ana e Qeverisë.

Qëllimi 3.2

Sigurimi i vazhdueshëm i menaxhimit efikas me rreziqet në punë

Proceset e biznesit në MAPAS promovojnë efektivitetin dhe efikasitetin e biznesit duke synuar drejt inovacionit, fleksibilitetit dhe integritetit me teknologjinë. Këto procese të biznesit janë të konfirmuara me implementimin e standardit Sistemi për menaxhimin me cilësinë ISO 9001:2015 dhe mirëmbajtjen e tij të vazhdueshme (certifikimin). Përmirësimi i vazhdueshëm i punës dhe proceseve të biznesit në MAPAS, përmirësimi i organizimit të aktiviteteve të punës dhe ndjekja e performancave, japin ndikim të madh pozitiv mbi mbarë sistemin dhe kontribuojnë drejt arritjes së mbikëqyrjes dhe kontrollit modern, efikas dhe profesional. MAPAS në vitet e ardhshme do të vazhdojë të bëjë vlerësimin e të gjitha proceseve, procedurave dhe sistemeve që janë në funksion dhe do të vazhdojë t'i përmirësojë proceset e biznesit.

Me qëllim që MAPAS të përgatitet për nevojat teknologjike në rritje që do të shfaqen në vitet e ardhshme, është e domosdoshme të hartojë Strategjinë e TI-së. Ky dokument përfshin planifikimin e arkitekturës, planifikimin e kostove dhe menaxhimin me sigurinë e të dhënave, kurse e gjithë kjo do të jetë e harmonizuar me qëllimet dhe kontrollet e biznesit.

Për shkak të trajtimit me kohë të të gjitha kërcënimeve dhe rreziqeve, MAPAS në vitin 2015 e implementoi dhe e mirëmban Sistemin për menaxhimin me sigurinë e informacioneve (ISO 27001:2013) i cili siguron nivel adekuat të sigurisë në kuptimin e konfidencialitetit, disponueshmërisë dhe integritetit të mjeteve informative të MAPAS. Plani për vazhdimësi në punën e biznesit, regjistri i rreziqeve si dhe plani për trajtimin e rreziqeve që janë pjesë e Sistemit për menaxhimin me sigurinë e informacioneve janë kyçë për shkak se sigurojnë të mbahet funksionaliteti i institucionit në situata të padëshiruara siç janë ndërprerja në furnizimin me energji, bllokimi në sistemin e TI-së, katastrofat natyrore, problemet me furnizimet etj. Përmirësimi i vazhdueshëm i këtij sistemi për menaxhimin me sigurinë e informacioneve në vitet e ardhshme është në drejtim të mirëmbajtjes së vlerës së palëve të interesuara përmes vlerësimit të vazhdueshëm dhe përmirësimit të sigurisë informative dhe ciklit të plotë për zhvillimin e vazhdueshëm të MAPAS.

Të udhëhequr nga i njëjti qëllim, në drejtim të përmirësimit të punës së vet MAPAS gjatë vitit 2018 vendosi Sistemin për menaxhimin me rrezikun, në bazë të të cilit u analizuan të gjitha proceset e biznesit, si nga Sistemi për menaxhimin me cilësinë, ashtu edhe nga Sistemi për menaxhimin me sigurinë e informacioneve. Me ndihmën e Sistemit për menaxhimin me rreziqet u siguroa përcaktimi, vlerësimi dhe kontrolli i ngjarjeve ose gjendjeve të mundshme që mund të kenë ndikim negativ mbi arritjen e qëllimeve. MAPAS me sukses i identifikoi rreziqet në punë në nivel të njëjësive organizative sipas metodologjisë, gjë që përfshin përcaktimin e rreziqeve, vlerësimin e rreziqeve, veprimin sipas rreziqeve dhe ndjekjen dhe raportimin për rreziqet. Qëllimi i menaxhimit me rrezikun është zvogëlimi dhe/ose mirëmbajtja e rreziqeve deri në nivelin e definuar të pranueshëm përmes ndërmarrjes së aktiviteteve përkatëse për çka është e domosdoshme ndjekja dhe vlerësimi i vazhdueshëm i rreziqeve.

Me qëllim që menaxhimi me rreziqet të bëhet pjesë përbërëse e procesit të planifikimit dhe marrjes së vendimeve, MAPAS është në proces të ndërtimit të kulturës në të cilën menaxhimi dhe komunikimi për rreziqet e përcaktuara do të bëhet praktikë mbi bazën e së cilës do të merren vendime përkatëse. Në vitet e ardhshme MAPAS do të vazhdojë ta zbatojë dhe ta përmirësojë Sistemin për menaxhimin me rreziqet.

Gjithashtu, MAPAS do t'i kushtohet aktivisht luftës kundër korrupsionit në të gjitha aspektet e punës së saj. Për këtë qëllim MAPAS në vitin 2023 miratoi Politikën për integritet në të cilën shprehet angazhimi dhe përcaktimi i MAPAS që të vendoset, implementohet dhe përmirësohet sistemi për integritet.

Qëllimi 3.3

Bashkëpunimi me trupa të tjerë mbikëqyrës në vend dhe jashtë vendit, anëtarësimi në shoqata ndërkombëtare dhe aplikimi i proceseve dhe rekomandimeve më të reja nga fusha e mbikëqyrjes, si dhe pjesëmarrja në projekte të organizuara nga institucione kompetente

Me qëllim të sigurimit të mbikëqyrjes dhe rregullativës efikase të sigurimit pensional me financim kapital, MAPAS do të vazhdojë të bashkëpunojë me trupat rregullatorë nga vendi dhe jashtë vendit dhe me organet dhe institucionet relevante në vend. Bashkëpunimi me këta trupa dhe institucione është i definuar me memorandume bashkëpunimi. Përmes këtyre bashkëpunimeve MAPAS do të vazhdojë t'i shfrytëzojë përfitimet nga përvojat dhe informacionet e mblidhura e kërkimet e ndara nga ana e institucioneve të tjera rregullatore.

MAPAS bashkëpunon me institucione rregullatore në disa vende siç janë Bullgaria, Sllovenia, Kroacia, Polonia, Turqia, Rumania, Kosova dhe Shqipëria. Në mars 2023 viti MAPAS filloi bashkëpunim edhe me Organin për rregullim dhe mbikëqyrje të sigurimeve dhe sigurimit pensional nga Turqia me nënshkrimin e Memorandumit për bashkëpunim. Bashkëpunimi me të gjitha institucionet rregullatore përfshin shkëmbimin e përvojave të fituara në fushën e sigurimit pensional të financuar me kapital, në funksionimin e fondeve pensionale, mekanizmat e mbikëqyrjes së fondeve pensionale dhe rregullativën e miratuar dhe masat ligjore. Një bashkëpunim i tillë kontribuoi në zhvillimin e kapacitetit të MAPAS. Gjithashtu, nga marsi i vitit 2007, MAPAS është anëtare me të drejta të plota e IOPS - Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve. MAPAS, si bazë dhe politikë në kuadër të ushtrimit të mbikëqyrjes së shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale, është përcaktuar të ndjekë Parimet për mbikëqyrje të Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve. Anëtarësimi dhe bashkëpunimi me IOPS kontribuon që MAPAS t'i ndjekë trendet në fushën e rregullativës dhe mbikëqyrjes së shoqërive dhe fondeve pensionale. MAPAS do të vazhdojë t'i avancojë këto bashkëpunime dhe do të vazhdojë të ndajë dhe shkëmbejë informacione dhe përvoja, të ndjekë standardet botërore dhe praktikatat pozitive nga fusha e mbikëqyrjes së shoqërive dhe fondeve pensionale.

Nga dhjetori i vitit 2013 MAPAS është pjesë e Trupit Koordinues për edukim financiar dhe përfshirje financiare, i cili u formua me qëllim të rritjes së nivelit të edukimit financiar të popullsisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Anëtarë të trupit koordinues janë institucionet rregullatore financiare NBRSM, MF, KHV, MAPAS dhe ASO. Trupi koordinues bashkëpunon me më shumë institucione nga sektori financiar në vend dhe jashtë vendit, ndërsa veçanërisht theksohet bashkëpunimi me Organizatën për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim - Rrjeti Ndërkombëtar për edukim financiar (OECD-INFE) dhe Organizata Ndërkombëtare për edukim financiar të fëmijëve dhe të rinjve (CYFI) si organizata dhe institucione ndërkombëtare me renome që në mandatet e tyre i përpunojnë rregullativat, temat dhe programet për edukim financiar, shkrim-lexim financiar dhe përfshirje financiare.

Në mars të vitit 2022 institucionet rregullatore në Maqedoninë e Veriut lidhën Memorandum për bashkëpunim të rregullatorëve financiarë për krijimin e kushteve për mbështetje të zhvillimit të inovacioneve në sistemin financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut me çka u vendos një sistem përmes të cilit rregullatorët do të veprojnë në mënyrë të koordinuar, secili në kompetencën e vet.

MAPAS në vitet në vijim do të marrë pjesë aktive në projekte që janë të lidhura me përmirësimin e funksionimit të sigurimit pensional të financuar me kapital. Një pjesë e këtyre projekteve do të dalin nga rekomandimet e vlerësimit të sektorit financiar nga ana e misionit të BB dhe FMN (FSAP) nga viti 2018. Gjithashtu, MAPAS do të marrë pjesë në aktivitetet e lidhura me projektin e Bankës Botërore për regjistër qendror të unifikuar dhe sistem për regjistrimin e të dhënave nga sigurimi social dhe pensional.

Në vitet në vijim MAPAS do të vazhdojë ta përmirësojë praktikën e vendosur të bashkëpunimit për shkak të ruajtjes së komunikimit të suksesshëm me trupat e tjerë mbikëqyrës dhe organet dhe institucionet relevante me qëllim që kjo të kontribuojë në ruajtjen e një sigurimi pensional të financuar me kapital stabil dhe transparent dhe përmirësimin e mbikëqyrjes së sigurimit pensional të financuar me kapital.

Qëllimi 3.4

Forcimi dhe mirëmbajtja e stabilitetit të vet financiar me qëllim zbutjen e ndikimeve të të gjitha segmenteve në fushëveprimin e veprimit, duke siguruar menaxhim efikas të financave

MAPAS në mënyrë të vazhdueshme i ndjek gjendjet dhe trendet që lidhen me punën e MAPAS dhe sistemit dhe e përmirëson dhe nxit zhvillimin e sigurimit pensional të financuar kapitalisht. Në atë drejtim, planifikohet zbatimi i aktiviteteve për rregullimin dhe implementimin e multifondeve dhe pritet vendosja e një Qendre për sistem elektronik të kotacionit. Këto ndryshime do të implikojnë rritje të kompetencave të MAPAS nga kapaciteti rregullator dhe mbikëqyrës, e me këtë edhe shpenzimet për forcimin e kapacitetit kadrovik dhe material të Agjencisë. Gjithashtu, MAPAS në mënyrë të vazhdueshme i përmirëson dhe i avancojnë proceset e punës në përputhje me nevojat dhe kërkesat e reja të të gjitha subjekteve të përfshira në sistemin e sigurimit pensional të financuar kapitalisht. Proceset e punës mbështeten me zgjidhje moderne softuerike dhe harduerike që kontribuojnë në shpejtësinë e reagimit të MAPAS dhe ndjekjen e pandërprerë të çdo ndryshimi që ndodh në këtë sistem. Për këtë arsye, një pjesë e madhe e shpenzimeve të MAPAS i referohen infrastrukturës së saj informatike.

Sigurimi pensional i financuar kapitalisht paraqet segmentin e dytë më të madh në sistemin financiar të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe është një nga segmentet me rritje më të

shpejtë në sistemin financiar. Në vitin 2022 pjesëmarrja e mjeteve totale të fondeve pensionale në shtyllën e dytë dhe të tretë në prodhimin e brendshëm bruto arrin 15% të PBB-së. Me këtë pritjet që trendi i përfshirjes së popullsisë dhe rritjes së mjeteve të fondeve private pensionale të vazhdojë edhe më tej. Kjo ndikon drejtpërdrejt në rritjen e përgjegjësisë së MAPAS si trup mbikëqyrës dhe rregullator në këtë segment, para të siguruarve dhe publikut.

Me analizat e mënyrës aktuale të përlllogaritjes dhe arkëtimit të kompensimit me të cilin financohet puna e MAPAS është konstatuar se shkalla e punësimit dhe masat demografike kanë ndikim negativ në kompensimin e strukturuar aktualisht, përkatësisht niveli dhe frekuenca e kontributeve ndikojnë drejtpërdrejt në financimin e MAPAS. Për tejkalimin e këtyre ndikimeve, stabilizimin e të ardhurave si dhe harmonizimin me praktikën e huaj, me qëllim realizimin e aktiviteteve që rrjedhin nga zhvillimi i mëtejshëm i sistemit, në bazë të analizave të përgatitura dhe duke siguruar kufizime maksimale, është përcaktuar nevoja për ndryshimin e mënyrës së përlllogaritjes së kompensimit që MAPAS e arkëton nga shoqëritë pensionale. Prandaj, MAPAS do të iniciojë ndryshim ligjor të mënyrës së përlllogaritjes së kompensimit, përkatësisht arkëtimin e një kompensimi mujor në barrë të shoqërive pensionale, të përlllogaritur si përqindje nga mjetet totale neto të çdo fondi pensional me të cilin menaxhon shoqëria pensionale.

MAPAS e mban kontabilitetin në përputhje me Ligjin për kontabilitet për organizata jofitimprurëse, Rregulloren për kontabilitet për organizata jofitimprurëse dhe parimet dhe standardet e pranuar të kontabilitetit, me qëllim paraqitjen e saktë, të vërtetë, të sigurt, gjithëpërfshirëse, në kohë, të përditësuar dhe individuale të pozicioneve të bilancit, me gjendjen e mjeteve, detyrimeve, burimeve të mjeteve, të hyrave dhe shpenzimeve dhe rezultateve nga puna. MAPAS do të vazhdojë t'i përgatisë dhe t'i prezantojë në mënyrë objektive dhe t'i kryejë raportet financiare. Kjo përgjegjësi përfshin: krijimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e kontrollit të brendshëm që është relevant për përgatitjen dhe prezantimin objektiv të raporteve financiare të cilat janë të liruara nga paraqitja materiale e gabuar, pa marrë parasysh nëse ajo është rezultat i mashtrimit apo gabimit, përzgjedhjen dhe zbatimin e politikave kontabël, si dhe bërjen e vlerësimeve kontabël të cilat janë të arsyeshme në rrethanat e dhëna.

MAPAS në vitet në vijim do të vazhdojë të sigurojë menaxhim efikas të financave, përfshirë edhe kontrollin e shpenzimeve operative dhe shfrytëzimin optimal të të hyrave. Në këtë drejtim MAPAS do të kryejë analiza të raporteve financiare, do t'i rishikojë vendimet për kompensime dhe do ta përcaktojë nevojën për përgatitjen e analizave shtesë të lidhura me financimin e MAPAS.

Qëllimi 3.5

Përmirësimi i menaxhimit të vet, planifikimit, transparencës dhe përgjegjësisë shoqërore

MAPAS do të vazhdojë ta përmirësojë menaxhimin e vet përmes mjeteve për menaxhimin e ndryshimeve, përkatësisht përmes analizimit të gjendjes momentale dhe përcaktimit të fushave që duhet të përmirësohen. MAPAS në vitin 2019 zbatoi një analizë funksionale. Analiza bëhet

për shkak të definimit të vendosjes dhe ndarjes së kompetencave të organizatës; rishqyrtimit se cilat njësi organizative dhe procese pune nuk janë efikase dhe efektive, prandaj si rrjedhojë duhet të transferohen, plotësohen, ndryshohen etj., si dhe të efikasitetit dhe efektivitetit në kryerjen e funksioneve dhe nevojës për rishikimin e proceseve të punës. Analiza e MAPAS, nga aspekti organizativ, detektoi nevojën për futjen e proceseve të reja dhe përmirësimin e proceseve dhe aktiviteteve ekzistuese të punës në korrelacion me kapitalin njerëzor ekzistues dhe punësimet e reja. MAPAS në vitet në vijim pret që implementimi i rekomandimeve konkrete të theksuara nga analiza, dhe në përputhje me kornizën e planifikuar për përmirësimin e kapaciteteve në MAPAS, do të çojë në përmirësimin e organizimit të brendshëm dhe proceseve të punës.

MAPAS do ta zhvillojë menaxhimin e vet edhe përmes përmirësimit të komunikimit dhe koordinimit ndërmjet të gjitha njësive organizative, si dhe përmes ngritjes së vetëdijes tek të punësuarit në lidhje me rreziqet në punë.

MAPAS do të vazhdojë edhe në vitet në vijim ta zbatojë dhe përmirësojë procesin e planifikimit strategjik si mjet për përshtatje të shpejtë dhe efikase ndaj kushteve të ndryshueshme të veprimit. MAPAS do të kryejë analizë të gjendjes ekzistuese në të cilën punon dhe vepron dhe mbi këtë bazë, në përputhje me kapacitetet dhe burimet e veta, në mënyrë reale dhe objektive do t'i përcaktojë qëllimet dhe gjendjet e synuara, aktivitetet dhe do t'i ndjekë dhe vlerësojë arritjet. Planifikimi dhe arritja e gjendjeve të synuara do të kryhet në kornizë kohore afatshkurtër dhe afatmesme duke siguruar menaxhim efikas të financave, duke përfshirë edhe kontrollimin e shpenzimeve operative dhe shfrytëzimin optimal të të ardhurave.

MAPAS zbaton mesatarisht nga 30 deri në 40 procedura për furnizime publike të mallrave, shërbimeve dhe punëve në varësi të nevojave në nivel vjetor. Në këtë drejtim, MAPAS i ndjek në mënyrë aktive ndryshimet dhe plotësimet ligjore dhe e përshtat punën e vet në përputhje me to, duke u adaptuar ndaj futjes së mënyrave moderne (elektronike) të zhvillimit të procedurave dhe evidentimit të tyre, gjë që kontribuon në praktikë më të madhe dhe pragmatizëm në zbatimin e tyre nga njëra anë, si dhe transparencë dhe llogaridhënie më të madhe nga ana tjetër. MAPAS do të vazhdojë me këtë mënyrë pune edhe në të ardhmen, duke synuar rritjen e kapaciteteve të veta me qëllim që me sukses dhe në mënyrë efektive të përgjigjet ndaj të gjitha sfidave që problematika e furnizimeve publike i sjell me vete.

Në vitet në vijim MAPAS do të vazhdojë edhe më tej të përmirësojë aktet që kanë të bëjnë me punën e MAPAS dhe në mënyrë përkatëse do t'i harmonizojë me ndryshimet e rregullativës përkatëse (marrëdhëniet e punës, siguria dhe shëndeti në punë, nëpunësit administrativë, mbrojtja e të dhënave personale, qasja në informacione me karakter publik, puna zyrtare dhe arkivore etj.). Pastaj, MAPAS do të vazhdojë të punojë për mirëmbajtjen e kushteve të sigurta dhe cilësore të punës në përputhje me kërkesat e biznesit, standardet dhe normat e përcaktuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut. MAPAS në vitet në vijim do t'i përkushtohet edhe aktiviteteve për përmirësimin e përgjegjësisë së saj shoqërore, përmes inicimit dhe përfshirjes në aktivitete për përmirësimin e aspekteve

sociale dhe etike të shoqërisë sonë dhe përmirësimin e mjedisit jetësor.

MAPAS në vitet e kaluara ka vendosur auditimin e brendshëm si aktivitet i pavarur për dhënien e sigurisë objektive dhe këshillimit, me qëllim që i njëjti të kontribuojë në rritjen e vlerës dhe përmirësimin e punës së MAPAS. Në vitet në vijim auditimi i brendshëm do të vazhdojë në mënyrë sistematike t'i vlerësojë dhe të japë rekomandime për përmirësimin e procesit të menaxhimit të rreziqeve, përshtatshmërisë dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme dhe përputhshmërisë së punës me rregulloret në fuqi, aktet e brendshme dhe procedurat e MAPAS. Auditimi i brendshëm do të vazhdojë t'i planifikojë, organizojë dhe zbatojë auditimet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore dhe standardet ndërkombëtare për auditim të brendshëm.

MAPAS siguron informim me kohë dhe të rregullt për punën e MAPAS përmes raporteve për punën dhe punën financiare të MAPAS, publikimin e njoftimeve të lidhura me punën e Këshillit të ekspertëve, furnizimet publike, projektet etj. Në vitet në vijim MAPAS do të vazhdojë të punojë në përmirësimin e transparencës përmes përmirësimit të cilësisë dhe përfshirjes së të dhënave dhe informacioneve për punën e saj për të gjitha palët e interesuara dhe përdoruesit e jashtëm.